



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 40 regjistër (JR)  
Datë 21.10.2024

Nr. 91 i vendimit  
Datë 11.12.2025

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 11.12.2025, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Rajmonda Berisha (Kopaçi), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 780, datë 03.07.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 dhe 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 46, 50 dhe 51 i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve

në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe në parashtrime, me anë të të cilave kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 780, datë 03.07.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Rajmonda Berisha (Kopaçi) (në vijim “subjekti i rivlerësimit/subjekti”), për shkak të funksionit, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në bazë të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.

1.1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit raportin përkatës<sup>1</sup>, duke konstatuar se: (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka burime financiare për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

2. Komisioni kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Rajmonda Berisha, bazuar në kriterin e vlerësimit të pasurisë. Me vendimin nr. 780, datë 03.07.2024, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në konkluzionin si më poshtë:

2.1. *Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar neneve Ç dhe D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, çmon se referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivelin kualifikues, pasi ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, ka bërë deklarim të rremë në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë dhe deklarim fiktiv të çmimit të blerjes dhe shitjes së pasurisë, duke cenuar me këto veprime besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, si të tilla, këto veprime, bazuar në nenin 61, pikat 5 e 3 të ligjit nr. 84/2016, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.*

### III. Shkaqet e ankimit

3. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), kundër vendimit objekt gjykimi, duke pretenduar se Komisioni ka vepruar në shkelje të rëndë të procedurës të procesit të rivlerësimit, të parashikuar në Aneksin e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe

---

<sup>1</sup> Me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.01.2020.

në ligjin nr. 84/2016. Me ankimin dhe parashtrimet para seancës gjyqësore, bashkëlidhur të cilave paraqiti disa akte,<sup>2</sup> subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji:

- *Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 780 vendimi, datë 03.07.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit, znj. Rajmonda Berisha.*
- *Shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave. Riçeljen e hetimit administrativ edhe për kriterin e dytë dhe të tretë të procesit të rivlerësimit, që lidhet me vlerësimin e figurës dhe të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Rajmonda Berisha.*
- *Ndryshimin e vendimit nr. 780, datë 03.07.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Rajmonda Berisha, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.*

#### **A. Shkaqet e ankimit që lidhen me zbatimin e ligjit dhe parimet e procesit të rregullt ligjor**

4. Për sa i përket argumenteve për cenim të procesit të rregullt dhe të aspekteve procedurale të procesit të rivlerësimit të saj, subjekti i rivlerësimit pretendon për shkelje të rënda të procedurës të parashikuar në kuadrin kushtetues dhe ligjor të rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur si vijon: (i) Komisioni nuk ka qenë në kushtet ligjore për të përfunduar hetimin administrativ dhe për të kaluar çështjen në seancë dëgjimore pa ezauruar të tria kriteret e vlerësimit, sikurse ligji e kërkon dhe, pavarësisht kërkesës së saj për riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera, të figurës dhe të aftësive profesionale, ka marrë vendim bazuar në shqyrtimin e vetëm një kriteri të rivlerësimit, atij të kontrollit të pasurisë, çka e bën procesin e saj të rivlerësimit të parregullt, në referim të ligjit nr. 84/2016 dhe të nenit 6/1 të KEDNj-së. (ii) Provat dhe faktet janë vlerësuar në mënyrë të njëanshme dhe joobjektive, në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin, nuk janë vlerësuar provat e paraqitura prej saj mbi burimin e të ardhurave për familjen. (iii) Nuk janë respektuar parimet e proporcionalitetit dhe të objektivitetit, Komisioni duhej të vlerësonte që nuk ka në pronësi apo posedim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme.

#### **B. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

5. Për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, në ankim, subjekti parashtroi si më poshtë:
- 5.1 Për pasurinë “apartament banimi 81 m<sup>2</sup>”, në lagjen “{\*\*\*}”, pallati {\*\*\*}, Elbasan, provat tregojnë për mundësinë për të krijuar vlerën prej 500.000 lekësh për blerjen e tij, në vitin 1996, vlerësimi i Komisionit është jashtë kontekstit ligjor dhe praktikës së kohës kur janë krijuar dhe përdorur të ardhurat.
- 5.2 Për pasurinë “apartament banimi me sip. 82 m<sup>2</sup>”, në lagjen “{\*\*\*}”, rruga “{\*\*\*}”, Vlorë, konkluzioni i Komisionit për të vlerësuar çmimin e kësaj pasurie, 64.000 euro, është joobjektiv dhe i pabazuar. Në deklaratën *vetting*, duke deklaruar çmimin real të blerjes së këtij apartamenti, në vlerën 48.000 euro dhe jo 64.000 euro, siç rezulton nga kontrata e kaparit, e datës 21.12.2007, nuk ka bërë

---

<sup>2</sup> Subjekti depozitoi në Kolegj, me nr. {\*\*\*} prot., datë 03.12.2025, “Kërkesë për administrimin dhe shqyrtimin e provës së re shkresore”, “Kontratë e Shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol.” dhe “Deklaratë noteriale dt. 30.10.2025, nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol.”, me lëndë “Parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e paraqitura në ankim nga subjekti i rivlerësimit, znj. Rajmonda Berisha (Kopaçi), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”.

deklarim të rremë. Deklarata e pasurisë e vitit 2007 provon se apartamenti është blerë në vlerën 48.000 euro, nuk ekziston asnjë kontratë shitblerje që provon të kundërtën e vlerës së blerjes së apartamentit. Nuk ka mungesë burimesh të ligjshme për shlyerjen e parakohshme në vitin 2011, të kredisë së marrë për blerjen e apartamentit. Depozitat bankare, shuma e tërhequr prej të cilave ka shërbyer për shlyerjen e parakohshme të kredisë, kanë qenë të krijuara me burime të ligjshme. Për likuiditetet *cash* të deklaruara të përdorura për këtë qëllim, si dhe për të tjera të përdorura për të krijuar pasuri dhe për të mbuluar shpenzimet, gjatë periudhës 2005 – 2016, nga përfshirja në analizën financiare e të ardhurave nga puna të bashkëshortit, P. B., provohet se ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e tyre.

**5.3** Lidhur me pasurinë “*automjet*” tip “*Mercedes - Benz CDI*”, me targë {\*\*\*}, nuk ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e tij në datën 29.04.2009, pasi deklarimet në deklaratën e pasurisë së vitit 2008, lidhur me të ardhurat e saj nga paga, të ardhurat e bashkëshortit nga paga dhe dietat, si dhe gjendjen *cash*, prej 500.000 lekësh, janë të mjaftueshme për të justifikuar çmimin e blerjes së automjetit.

**5.4** Komisioni konkludon, me të padrejtë, se duket se ka tendencë të përsëritur të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit të saj për të deklaruar çmime fiktive në transaksionet (shitjet dhe blerjet) e automjeteve, me qëllimin për të justifikuar mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, përkundrajt provave të pakontestueshme, siç janë kontratat e shitblerjes dhe deklarimet periodike vjetore, ku pasqyrohen veprimet e shitblerjes.

**5.5** Lidhur me pasurinë “*depozita bankare në emër të vajzave, Xh. B. dhe H. B.*”, nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e tyre, në vitin 2003, dhe për shtesat në vitin 2007. Komisionit i rezultojnë balanca negative për shkak të analizës financiare fragmentare dhe mospërfshirjes së të ardhurave të bashkëshortit nga paga dhe dietat.

**5.6** Lidhur me krijim e *fondit Invest Prestige pranë Raiffeisen Bank*, mund të ketë pasur pasaktësi në mënyrën si është deklaruar në deklaratën *vetting*, por nuk ka pasur ndryshim deklarimi nga deklaratat periodike të pasurisë. Për shkak të analizës financiare të fragmentuar dhe të moskonsiderimit të të ardhurave të bashkëshortit nga dietat, në mënyrë të padrejtë, Komisioni arrin në konkluzionin për mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e depozitave bankare.

**5.7** Lidhur me të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit, P. B., të gjitha të deklaruara në deklaratat periodike të pasurisë, si edhe ato të përfituara nga dietat, duhet të përfshihen në analizën financiare. Konkluzioni i Komisionit, se faktet tregojnë se punëdhënësi e punëmarrësi mund të jenë dakordësuar që të mos regjistrohen dhe deklarohen vlerat e dietave, çka i bën ato të paligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe të pamatshme, është tërësisht i pabazuar në fakte dhe në prova. Referuar legjislacionit tatimor, të ardhurat nga dietat nuk i nënshtrohen detyrimeve tatimore, janë të matshme, pasi janë deklaruar në deklarimet periodike, shuma e përfitur nga dietat, nga udhëtimet brenda dhe jashtë vendit, e cila nuk është përdorur për konsum ushqimor dhe akomodim (ushqimi mbuluar me të ardhurat familjare, akomodimi tek të afërt), ka qenë e ardhur reale për familjen dhe është përdorur për shpenzime dhe krijim të pasurive.

#### IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

###### i. Juridiksioni i Kolegjit

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### ii. Legjitimimi i ankuesit

7. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### iii. Forma e gjykimit

8. Në parashtrimet lidhur me shkaqet e paraqitura në ankim, të paraqitura përpara seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit konfirmoi sa parashtruar në ankimin drejtuar Kolegjit, duke bashkëlidhur dy dokumente, dhe kërkoi administrimin dhe shqyrtimin e tyre si prova të reja në gjykim.
9. Lidhur me kërkesat e subjektit për marrjen e provave të reja. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit, si rregull, kryhet në dhomën e këshillimit. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi. Trupi gjykues shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të pranuar, në cilësinë e provave të reja, aktet e sjella me parashtrime, nën dritën e parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, nëse ekzistonin rrethanat e pretenduara për të tejkuluar pengesën procedurale të parashikuar në nenin 49 të ligjit<sup>3</sup>, si dhe i vlerësoi këto akte edhe në kuptim të neneve 45 e 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me ndikimin që mund të kishin për çështjet e trajtuara në vendimin objekt shqyrtimi.
10. Lidhur me “Kontratë shitje pasuri e paluajtshme”, nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 30.10.2025<sup>4</sup>, subjekti shpjegon se ky akt është krijuar vetëm pasi u bë e mundur hipotekimi i godinës së ndërtuar

<sup>3</sup> Ligji nr. 49/2012, në nenin 49, “Gjykimi në apel administrativ në dhomë këshillimi”, në pikën 2, parashikon: “... Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim”.

<sup>4</sup> Kontrata është paraqitur kopje e noterizuar me nr. {\*\*\*} rep., datë 20.11.2015, bashkëlidhur saj, me vulë të noterit, rezultojnë dokumentet: (i) Ekstrakt i QKB-së për “{\*\*\*}” ShPK, datë 30.10.2025; (ii) Certifikatë regjistrimi pronësie për pasurinë me nr. {\*\*\*}, apartament me sipërfaqe 67 m<sup>2</sup>, pronar “{\*\*\*}” ShPK, datë lëshimi 15.08.2025; (iii) kartela e pasurisë dhe fragment i hartës kadastrale (gjeneruar dhe vulosur me procedurë automatike nga sistemi elektronik); (iv) gjendje llogarie i “{\*\*\*}” ShPK, nga Alpha Bank. Gjithashtu, me parashtrimet, subjekti paraqiti deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.10.2025, të shtetasit Th. B.

nga shoqëria ndërtuese/shitëse, fakt i pranuar edhe nga Komisioni. Subjekti e paraqet këtë akt me pretendimin se, sipas çmimit të shitblerjes në kontratë, vlera e blerjes së apartamentit në Vlorë është 48.000 euro, ndërsa sipërfaqja e tij është 67 m<sup>2</sup>, fakte që provojnë vërtetësinë e deklarimeve të saj, në deklaratat periodike dhe në deklaratën *vetting*, lidhur me çmimin e blerjes. Ky akt provon se nuk ka pasur deklarim fiktiv të çmimit të shitjes/blerjes së kësaj pasurie, përtej çdo dyshimi provon vlerën reale të paguar dhe se kontrata e kaparit nuk është ekzekutuar kurrë, pra nuk është paguar vlera prej 16.000 eurosh, potencon subjekti.

11. Trupi gjykues, pavarësisht se konstatoi se qëndrojnë rrethanat e pretenduara prej subjektit, që kanë përcaktuar kohën e paraqitjes së këtij akti, sipas parashikimit të nenit 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, e konsideroi marrjen e tij të panevojshëm për zgjidhjen e çështjes, pasi fakti që subjekti synon të provojë në favor të saj, edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit. Në vijim, analiza e trupit gjykues.

11.1. Referuar akteve bashkëlidhur kontratës, konstatohet se datat e pasqyruara në dokumentet e pronësisë së palës shitëse, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, datojnë në korrik 2025, fakt i cili ka kushtëzuar tjetërsimin e pronësisë së apartamentit nga kjo shoqëri te subjekti i rivlerësimit. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se tejkalohet pengesa procedurale në kuptim të neneve 47 e 49 të ligjit nr. 49/2012, të cilat si rregull nuk lejojnë paraqitjen e provave të reja në fazën procedurale në të cilën i ka paraqitur subjekti. Për pasojë, trupi gjykues vlerësoi ndikimin që mund të kenë në zgjidhjen e çështjes, faktet që provohen me anë të këtyre dokumenteve, në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016.

11.2. Referuar përmbajtjes së kontratës sipërcituar, me objekt shitjen e pasurisë “*Apartament me sipërfaqe 112 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në qytetin e Vlorës*”, pasqyrohet se për pasurinë me të dhëna: “*Pronësia e {\*\*\*} ShPK, nr. pasurie {\*\*\*}, sipërfaqe banimi 67 m<sup>2</sup>... Lloji i pasurisë apartament*”, pala shitëse, shoqëria “{\*\*\*}”, përfaqësuar nga administratori I. A., dhe pala blerëse, subjekti i rivlerësimit dhe z. P. B. (bashkëshorti), kanë rënë dakord dhe me marrëveshje vendosën çmimin e shitjes së kësaj pasurie, në shumën 48.000 euro, vlerë e shlyer totalisht sipas Kontratës së Kaparit nr. rep. {\*\*\*}, nr. kol. {\*\*\*}, datë 21.12.2007, hartuar te notere J. V., deklaratës noteriale nr. rep {\*\*\*}, nr. kol. {\*\*\*}, datë 26.01.2021, hartuar te notere J. V., dhe faturave bashkëlidhur. Gjithashtu, në kontratë, pasqyrohet se jep pëlqimin në akt Th. B., i cili ka nënshkruar nën këtë cilësi, e për të cilin në akt referohen vetëm të dhënat personale.

11.3. Lidhur me aktet e cituara në kontratën si më sipër, në të cilën palët shprehen se: “*ranë dakord dhe me marrëveshje vendosën çmimin e shitjes së kësaj pasurie, në shumën 48.000 euro*”, konstatohet si vijon:

11.3.1. Kontrata e Kaparit nr. rep. {\*\*\*}, nr. kol. {\*\*\*}, datë 21.12.2007, të cilën subjekti e ka paraqitur si dokumentacion ligjor me deklaratën *vetting*, është lidhur me palë shitëse të ardhshme, Th. B., palë blerëse të ardhshme, subjekti dhe bashkëshorti, të cilët kanë rënë dakord për shitjen e një apartamenti të tipit “B-3” të përbërë “1+1”, në katin e tetë nga toka, sipas skicës bashkëlidhur, në godinën që ka filluar të ndërtohet nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, mbi truallin në pronësi të shtetasit Th. B., kundrejt çmimit prej 64.000 euro. Në kontratë përcaktohet se pala marrëse e kaparit dhe shitëse e ardhshme, zoti Th. B., dhe blerësi i ardhshëm kanë rënë dakord për pagesën e çmimit në dy këste, në datën e nënshkrimit të kontratës është likuiduar shuma prej 16.000 euro dhe brenda datës 15.02.2008 do të likuidohet shuma prej 48.000 euro; se çmimet e kontraktuara janë fikse e të pandryshueshme, në rast se pala blerëse e ardhshme nuk shlyen këstin edhe pas tre muajsh nga data

e caktuar në kontratë, palës shitëse të ardhshme i lind e drejta të kontraktobjë shitjen e apartamentit te persona të tretë dhe pala blerëse e ardhshme do të humbasë plotësisht shumën e paguar si këst të parë.

11.3.2. Sipas deklaratës noteriale nr. rep. {\*\*\*}, nr. kol. {\*\*\*}, datë 26.01.2021, e depozituar prej subjektit në Komision, hartuar para së njëjtës notere ku është nënshkruar edhe kontrata e kaparit, shtetasi Th. B. deklaroi se: *ndërmjet tij dhe P. e Rajmonda Berisha është nënshkruar kontrata e kaparit, legalizuar prej noteres me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.12.2007, në të cilën janë akorduar kushtet për shitblerjen e një apartamenti në banesën ndërtuar sipas lejes së ndërtimit... pavarësisht se në kontratë është cituar se shuma 16.000 euro është likuiduar para nënshkrimit të kontratës, ai e ka nënshkruar me mirëbesim, pasi klientët i kishin premtuar se këtë shumë do t'ia likuidonin më pas dhe, duke qenë në rrethana njohje personale, e pranoi... prej P. B. dhe Rajmonda Berishës nuk ka marrë asnjëherë deri më sot, as me pagesë cash e as me pagesë bankare, shumën e mësipërme.*

11.4. Përpos kontratës së shitjes, me parashtrime, subjekti ka paraqitur edhe deklaratën noteriale të shtetasit Th. B., nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.10.2025, i cili në këtë deklaram të dytë, deklaroi: *se ka nënshkruar kontratën e kaparit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.12.2007, notere J. V. dhe deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.01.2021, notere J. V... në cilësinë e investitorit, në ndërtimin e objektit deklaroi se ka shitur në favor të z. P. B. dhe znj. Rajmonda Berisha pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 67 m<sup>2</sup>”, me kod unik {\*\*\*}. Për sa më sipër kemi rënë dakord që çmimi i shitjes së pasurisë së lartpërshkruar është përcaktuar nga ne në vlerën 48.000 euro dhe jo 64.000 euro. Po ashtu deklarojmë se kjo vlerë është likuiduar totalisht dhe biem dakord që të nënshkruhet akti përfundimtar i shitblerjes midis shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe z. P. B. dhe znj. Rajmonda Berisha.*

11.5. Në kontratën e shitjes me nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 30.10.2025 mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, dhe subjektit e bashkëshortit të saj, përcaktohet se çmimi i rënë dakord, prej 48.000 euro, është likuiduar sipas dy akteve të përshkruara më sipër dhe *faturave bashkëlidhur*. Bashkëlidhur kontratës rezultoi vetëm gjendja e llogarisë bankare e shoqërisë pranë Alpha Bank, për periudhën 01.12.2006 – 11.06.2008, ku evidentohet se, në datën 28.12.2007, ka kaluar shuma 47.644 euro, me përshkrimin: *“Sa kaluar nga P. B. në favor të {\*\*\*} ShPK për blerje apartamenti”*. Krahas këtij veprimi, përpara dhe pas kësaj date, në këtë llogari evidentohen shumë veprime të tjera të kryera nga Th. B., apo për llogari të tij, me përshkrim *“Sa kaluar nga Th. B.”*, *“Tërheqje nga Th. B.”*, *“Sa kaluar në favor të Th. B.”*. Me deklaratën *vetting*, subjekti ka depozituar pasqyrën e llogarisë bankare të bashkëshortit, ku pasqyrohet i njëjti veprim sikundër në llogarinë bankare të shoqërisë. Në Komision, sikundër në ankim, subjekti ka fokusuar pretendimet e saj vetëm të çmimi i paguar, duke pretenduar se ai është 48.000 euro, sa provohet nga dokumentacioni bankar se është kaluar në llogari të shoqërisë ndërtuese, pa dhënë shpjegime përse kontrata e kaparit është lidhur me shtetasin Th. B.

11.6. Në lexim harmonik të akteve të sipërcituara, e specifikisht të deklarimeve të marrësit të kaparit, Th. B. – *që fillimisht deklaroi se ende nuk e ka marrë shumën 16.000 euro, si pjesë të çmimit prej 64.000 euro, të parashikuar në kontratën e kaparit, e më pas se kanë rënë dakord për çmimin e shitjes së pasurisë, në vlerën 48.000 euro* – si rasti më tipik i qasjes në favor të interesave të subjektit të rivlerësimit, duke modifikuar deklaramet përpara noteres, trupi gjykues vlerëson se dokumentacioni i paraqitur prej subjektit, mbi të cilin ajo synon të mbështesë pretendimin se çmimi i paguar për këtë

pasuri është 48.000 euro, nuk arrin nivelin e duhur të provueshmërisë dhe nuk zhbën faktet që deklarohen në kontratën e kaparit, e hartuar në kohën e ndodhjes së veprimit juridik.

**11.6.1.** Në këtë kontekst, konstatohet se kontrata e kaparit është bazuar në aktet administrative e noteriale të cituara: (1) kontratë investimi, legalizuar në datën 05.01.2006, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., modifikuar në datën 18.10.2006 me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., modifikuar më datë 25.01.2007 me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.; (2) lejes së ndërtimi, miratuar prej KRRt-së së Bashkisë Vlorë me nr. {\*\*\*}, datë 15.09.2006. Me deklaratën *vetting*, prej subjektit është depozituar vendimi i KRRt-së së Bashkisë Vlorë nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2005, “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij”, në emër të pronarit të truallit, Th. B., për objektin 8-9 kate, 3 kate dyqane, 6 kate banim + parkim nën tokë, në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, zbardhur në datën 16.10.2006.

**11.6.2.** Nga sa më sipër, duket se pronari i truallit, Th. B., dhe shoqëria ndërtuese, “{\*\*\*}” ShPK, lidhur me investimin në godinë kanë dakordësuar me aktet noteriale të cituara në kontratën e kaparit, e në bazë të tyre, shtetasi Th. B. ka futur në qarkullim civil pjesën e tij takuese, përmes kontratës së kaparit lidhur me subjektin dhe bashkëshortin e saj. Në këtë kontekst, konstatohet se kontrata e kaparit, në aneksin e saj, parashikon se në vijim të pikës C.6 të kontratës, pala shitëse e ardhshme dhe pala blerëse ardhshme kanë rënë dakord që apartamenti t’i dorëzohet kësaj të fundit me punimet e detajuara, të cilat listohen në vijim. Për rrjedhojë edhe të këtyre parashikimeve kontraktore, për të cilat analizohet gjerësisht në vijim në shkaqet e ankimit për themelin, dëshmohet se me kontratën e kaparit, shtetasi Th. B. dhe subjekti e bashkëshorti i saj kanë përcaktuar kushtet e shitjes së pasurisë, e në këtë kontekst, dhënia/marrja e kaparit garantonte shitjen e pasurisë. Përpos sjelljes si pronar të pasurisë së ardhshme, dinamika e veprimeve financiare mes shtetasit Th. B. dhe shoqërisë ndërtuese, dëshmuar nga llogaria bankare e shoqërisë, të kryera prej tij apo nga firma për llogari të tij, dëshmojnë edhe për ekzistencë të marrëdhënieve financiare në kuadër të marrëveshjes mes tyre për investimin në godinën që po ndërtohej.

**11.7.** Në këto kushte, mbështetur në analizën e të gjitha të dhënave të përmendura më lart, trupi gjykues vlerëson se përcaktimi i çmimit prej 48.000 euro, si i paguar për blerjen e kësaj pasurie në kontratën e shitblerjes së saj, nuk zhbën vërtetësinë e fakteve të pasqyruara në kontratën e kaparit, në kohën e dakordësisë së palëve për t’u futur në këtë marrëdhënie juridike. Përcaktimi i këtij çmimi në kontratën e shitblerjes, ndonëse përkon me deklaratimet e subjektit për vlerën e shpenzuar për blerjen e pasurisë, sërish duket se vjen në kundërshtim me atë që është pasqyruar në kontratën e kaparit të lidhur në vitin 2007, e cila, për më tepër, referohet në kontratën e shitblerjes, si marrëveshja mbi të cilën mbështetet vetë hartimi i kësaj kontrate. Ky kontradiksion, i parë veçanërisht në këndvështrim të kohës kur është hartuar kjo kontratë, që daton pas marrjes së vendimit të Komisionit për shkarkimin e subjektit, mbështetur edhe në problematika që lidheshin me përcaktimin e këtij çmimi, reflekton në vlerësimin e trupit gjykues, më shumë se përcaktimin e çmimit real të shitjes, përcaktimin e një çmimi që i konveniente subjektit në kuadër të procesit të tij të rivlerësimit.

**11.8.** Në këto kushte, trupi gjykues arriti në përfundimin se faktet që synojnë të provohen nga kjo kontratë dhe deklaratë noteriale, nuk do të shkaktonin një vlerësim të ndryshëm të fakteve që burojnë prej akteve të tjera të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, prandaj refuzoi marrjen e tyre me cilësinë e provës së re, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

12. Gjithashtu, në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe në vlerësim të të gjitha pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me procesin e rregullt, trupi gjykues nuk identifikoi shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të diktonin formën e gjykimit në seancë gjyqësore publike, e po ashtu nuk evidentoi konstatim të gabuar të situatës faktike në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegj, për korrigjimin e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Për pasojë, trupi gjykues vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit dhe në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit në Komision.

***B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni***

13. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se zhvillimi i procesit të rivlerësimit të saj dhe vendimi i marrë prej Komisionit, bazuar në shqyrtimin e vetëm të një kriteri të rivlerësimit, atij të pasurisë, e bën procesin e rivlerësimit të parregullt, në referim të ligjit nr. 84/2016 dhe të nenit 6/1 të KEDNj-së.

13.1. Lidhur me këtë pretendim, për të cilin subjekti potencon se: *mos hetimi për të tria kriteret bën që të ketë elemente të theksuara të paragjykitimit, të një vendimi të paracaktuar, dhe dalje jashtë diskrecionit që ligji i ka dhënë Komisionit, çfarë bën që prej saj të vihet seriozisht në dyshim fakti nëse është gjykuar apo jo nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, në konsideratë të qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit<sup>5</sup>, trupi gjykues sjell në vëmendje se parashikimet e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, lidhur ngushtë e në harmoni me përcaktimet e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, përcaktojnë qartazi se rivlerësimi është një proces i cili jo domosdoshmërisht fillon dhe finalizohet me shqyrtimin e të tria kriterëve të procesit të rivlerësimit. Fakti që për shpjegimet dhe provat e paraqitura prej subjektit gjatë hetimit administrativ kryesisht, Komisioni nuk ka mbajtur qëndrim të njëjtë me sa pretenduar prej saj, nuk përbën shkak për të pretenduar se Komisioni nuk ka qenë në kushtet ligjore për të përfunduar hetimin administrativ dhe për të kaluar çështjen në seancë dëgjimore pa ezauruar hetimin për të tria kriteret e vlerësimit.

13.2. Nga aktet në dosjen gjyqësore, konstatohet se, në datën 25.06.2024, bashkë me prapësimet dhe provat lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, subjekti i rivlerësimit ka dërguar edhe një kërkesë për riçelje të hetimit për dy kriteret e tjera të rivlerësimit (kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale). Komisioni, me vendimin e datës 27.06.2024, ka vendosur mospranimin e kësaj kërkesë, duke argumentuar se deri në këtë fazë nuk ekzistojë shkaqe për riçelje të hetimit, dhe duke u shprehur se ky vendim do të rivlerësohet pas seancës dëgjimore. Vlerësimi i shpjegimeve dhe i provave të paraqitura prej subjektit në përmbushje të barrës së provës bëhet nga Komisioni, pas zhvillimit të seancës dëgjimore dhe para dhënies së vendimit përfundimtar, qasje që paraqitet në përputhje me parashikimet e nenit 48 të Kodit të Procedurave Administrative<sup>6</sup>, si dhe të nenit 57, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016<sup>7</sup>. Nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, konstatohet se për

<sup>5</sup> Shih vendime të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ndër të tjera: nr. 3/2018, datë 17.07.2018; nr. 1/2019 (JR), datë 31.01.2019; nr. 3/2019 (JR), datë 07.02.2019; nr. 8/2019 (JR), datë 16.04.2019; nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019; nr. 28/2019 (JR), datë 24.10.2019; nr. 24/2021 (JR), datë 28.07.2021 dhe nr. 9/2022 (JR), datë 11.04.2022.

<sup>6</sup> Neni 48 i Kodit të Procedurave Administrative përcakton: “Organi publik, në çdo rast, është i detyruar të vlerësojë me shkrim mendimet dhe shpjegimet e të gjitha palëve të paraqitura, në përputhje me nenin 47 të këtij Kodi”.

<sup>7</sup> Neni 57, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: “[...] 4. Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban: a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues; b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështeten

çdo çështje të trajtuar, Komisioni ka referuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, duke dhënë edhe vlerësimin lidhur me to. Fakti që edhe provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti në përgjigje të barrës së provës, nuk janë konsideruar të mjaftueshme për të ndryshuar rezultatet e hetimit administrativ, nuk tregojnë për paragjykim apo paracaktim të vendimit, por që Komisioni ka pasur një vlerësim të ndryshëm nga ai i pritshëm prej subjektit të rivlerësimit. Për pasojë, vlerësohet se vetë përmbajtja e arsytimit të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, provon se ky pretendim i subjektit është i pambështetur në situatën faktike. Për sa për shpjegimet dhe provat e paraqitura në parashtrime dhe në seancën dëgjimore, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka dështuar të provojë të kundërtën e gjetjeve të rezultuara për kriterin e pasurisë, pretendimi i subjektit se: *vlerësimi përfundimtar vetëm mbi bazën e një kriteri, atij të pasurisë, kur nuk përmbushen kushtet e parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj për të përfunduar hetimin vetëm më një kriter, përbën një shkelje të rëndë të nenit Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe të nenit 6/1 të KEDNj-së*, vlerësohet haptazi i pabazuar. Trupi gjykues, duke sjellë në vëmendje se vlerësimi i provave është ushtrim prej Komisionit i kompetencave dhe i atributëve të tij analizuuese e vlerësuese, të njohura nga ligji nr. 84/2016, në funksion të përcaktimit të gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, edhe për sa do të analizohet gjerësisht më poshtë në këtë vendim, e gjen të bazuar vendimin e Komisionit për të përfunduar procesin e rivlerësimit për subjektin vetëm mbi bazën e vlerësimit të kriterit të pasurisë, në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, lidhur ngushtë dhe në harmoni me përcaktimet e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për paragjykim, vendim të paracaktuar, shkelje të rënda të procedurës së procesit të rivlerësimit, vlerësohen prej trupit gjykues të pabazuara.

14. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk janë respektuar parimet e proporcionalitetit dhe të objektivitetit. Sipas saj, Komisioni duhej të vlerësonte që nuk ka në pronësi apo posedim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Në kuptim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, deklaratat e pasurisë mund të përdoren si provë prej Komisionit, por kjo nuk do të thotë që masa ekstreme e shkarkimit nga detyra e subjektit të rivlerësimit të merret për plotësim në mënyrë jo të saktë, të gabuar të tyre, për sa të ardhurat dhe pasuritë janë deklaruar rregullisht dhe nuk ka deklarim të rremë, fshehje të pasurive apo burimit të krijimit të tyre, potencoi subjekti.

14.1. Nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues, *së pari*, konstaton se pretendimet lidhur me deklarim të saktë të të ardhurave dhe pasurive, për shpjegim të bindshëm të burimit të krijimit të tyre, se nuk ka përpjekje për fshehje të pasurisë, se nuk ka pasuri më të madhe se dyfishi i të ardhurave të ligjshme, subjekti i ka paraqitur edhe me parashtrime në Komision dhe ka marrë përgjigje lidhur me to në vendim. *Së dyti*, masa disiplinore për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit është marrë pasi prej Komisionit është konstatuar se nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, si rrjedhojë, është në kushtet e parashikuara në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, lexuar së bashku me nenin 33 të këtij ligji, për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit është gjetur në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për disa pasuri, ka kryer deklarim të rremë lidhur me burimin e krijimit të pasurisë dhe deklarim fiktiv të çmimit të

---

*vendimet; c) raportin dhe rekomandimin e relatorit; ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi. 5. Pjesa urdhëruese, ndërmjet të tjerash, përmban: a) alternativën që ka vendosur trupi gjykues; b) nëse trupi gjykues ka vendosur të caktojë një masë disiplinore; c) të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij”.*

blerjes dhe shitjes së pasurisë (lidhur me disa automjete), duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Situatat ligjore, të cilat pasjellin shkarkimin nga detyra, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, janë autonome, e në këtë kuptim, mjafton të gjendet e plotësuar një prej kushteve të parashikuara në njërin prej pikave për të pasjellë dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për sa më lart, ky pretendim është i pabazuar në ligj. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi mënyrën e deklarimit të pasurive dhe klasifikimit të tyre në pasaktësi apo të kryera pa qëllim, fshehjen apo deklarimin e rremë, trupi gjykues sjell në vëmendje se do të analizohen në vijim, në këtë vendim, së bashku me shkaqet e ankimit me natyrë materiale, që lidhen me analizimin e problematikave të pasurive të subjektit të rivlerësimit. *Së treti*, trupi gjykues çmon të theksojë se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra është dhënë prej Komisionit në raport me analizimin dhe vlerësimin e pasurive dhe burimeve të krijimit të tyre në deklaratën *vetting*, dhe jo për sa konstatuar në deklaratat periodike të pasurisë ndër vite, të dorëzuara pranë ILDKPKI-së (në vijim “DPV”), të cilat janë përdorur si provë në këtë proces, ashtu sikundër neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i subjektit vlerësohet prej trupit gjykues, i pabazuar.

14.2. Në vijim të sa më sipër, lidhur me pretendimin e subjektit i rivlerësimit se: *Vendimi i Komisionit vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, pasi për sa nuk konstatohen problematika në lidhje me kriterin e figurës dhe të aftësive profesionale, në të kundërt do të ishin bërë të ditura me rezultatet e hetimit, për kriterin e pasurisë në nivel autonom, me atë gfarë arsyetohet në vendim, nuk vërehet cenimi i besimit të publikut*, trupi gjykues vëren Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke vlerësuar se subjekti ka bërë deklaram të rremë lidhur me burimin e krijimit të pasurisë (“*apartamentit në Vlorë*”) dhe deklarim fiktiv të çmimit të blerjes dhe shitjes së pasurisë (*shfaqje e përsëritur e tendencës për të deklaruar çmime fiktive në transaksionet (shitjet e blerjet) e automjeteve nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, me qëllim justifikimin e mungesës së burimeve të ligjshme*). Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues konstatoi se problematikat mbi të cilat ishte bazuar konkluzioni i Komisionit, për cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, ishin të njëjtat me ato të analizuar në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë. Mbështetur në një analizë të plotë të këtyre problematikave, në vijim të këtij arsyetimi, trupi gjykues arriti në konkluzionin se ato shërbejnë si shkaqe që përcaktojnë vlerësimin për kriterin e pasurisë dhe nuk mund të konsiderohen sërish edhe në kontekstin e vlerësimit të përgjithshëm të të tria kriterëve sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit u vlerësua prej trupit gjykues, i bazuar.

### ***C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë***

*Të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, z. P. B.*

15. Trupi gjykues, për lehtësi leximi të këtij vendimi, çmoi të marrë në analizë, së pari, shkakun e ankimit lidhur me të ardhurat e deklaruara nga bashkëshorti i subjektit, z. P. B., duke qenë se këto të ardhura janë deklaruar si burim krijimi i pasurive objekt kontrolli, në funksion të shkaqeve të ankimit të subjektit për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
16. Në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit, z. P. B., ka deklaruar të ardhura nga puna si shofer pranë disa institucioneve dhe shoqërive private për periudhën 01.07.1980 – 31.12.2016, një pjesë e të cilave vijnë nga dietat, si vijon:

(i) Periudha 01.07.1980 – 15.06.1990: të ardhura nga puna si shofer pranë {\*\*\*}, qyteti Bajram Curri, Rrethi Tropojë. Vlera: 816.000 lekë. Sipas ligjit të unifikimit të pagave, pas një përlllogaritjeje të përafërt për këtë periudhë, paga rezulton 816.000 lekë, e faktuar kjo me vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 24.1.2017, lëshuar nga Dega e Sigurimeve Shoqërore Tropojë.

(ii) Periudha 09.07.1990 – 16.09.1993: të ardhura nga puna si shofer për transport ndërkombëtar, të mallrave, në {\*\*\*}, Durrës, Vlera 273.600 lekë. Bazuar në librezën e punës me nr. regjistri themeltar {\*\*\*}. Për arsye të mosdisponimit të dokumentit përkatës nga kjo ndërmarrje, si pasojë e mosekzistencës së saj, paga për periudhën e lartpërmendur rezulton 273.600 lekë.

(iii) Periudha 05.10.1993 – 13.11.1995: të ardhura nga puna si shofer për transport ndërkombëtar të mallrave pranë firmës “{\*\*\*}”, Kavajë. Vlera 25.000 \$. Duke qenë që periudhat e sipërpërmendura përkojnë me periudhën e tranzicionit, kam punuar në të zezë, duke u paguar në varësi të rrugës, me mandat dore. Një pjesë e këtyre mandateve është dorëzuar në deklaratimet e bëra më parë në zyrat e ILDKPKI-së.

(iv) Periudha 01.03.1996 – 17.02.2003: të ardhura nga puna si shofer për transport ndërkombëtar të mallrave pranë firmës “{\*\*\*}”, Tiranë. Vlera 54.000 DM. Duke qenë që periudhat e sipërpërmendura përkojnë me periudhën e tranzicionit, kam punuar në të zezë duke u paguar në varësi të rrugës, me mandat dore. Një pjesë e këtyre mandateve është dorëzuar në deklaratimet e bëra më parë në zyrat e ILDKPKI-së.

(v) Periudha 01.03.2003 – 31.12.2007: të ardhura nga puna si shofer autobusi në linjën Tiranë – Athinë – Tiranë, pranë firmës “{\*\*\*}”, Tiranë. Vlera 647,637 lekë. Një pjesë e të ardhurave për këtë periudhë kohore vijjnë nga dietat e deklaruara ndër vite, por të cilat nuk më janë vënë në dispozicion aktualisht nga firma në fjalë. Vlera 16.820 euro.

(vi) Periudha 01.02.2008 – 28.02.2013: të ardhura nga puna si shofer autobusi në linjën Tiranë – Athinë – Tiranë, pranë firmës “{\*\*\*}”, Lushnjë. Vlera 1.406.904 lekë. Një pjesë e të ardhurave për këtë periudhë kohore vijjnë nga dietat. Vlera 54.900 euro.

(vii) Periudha 04.04.2013 – 31.12.2016: të ardhura nga puna si shofer autobusi në linjën ndërkombëtare turistike, në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, Tiranë. Vlera 746.104 lekë. Një pjesë e të ardhurave për këtë periudhë kohore vijjnë nga dietat. Vlera 36.600 euro.

17. Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur me deklaratën *vetting*, atij të administruar gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

17.1. Të mos përfshijë në analizën financiare të ardhurat e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit, të deklaruara: (i) nga puna si shofer pranë {\*\*\*}, qyteti Bajram Curri, dhe nga puna si shofer për transport ndërkombëtar të mallrave, në {\*\*\*}, Durrës, pasi ka rezultuar se dy deklaratimet përputhen me dokumentacionin e administruar<sup>8</sup> sa i përket periudhave të punësimit, por jo me të ardhurat e

<sup>8</sup> Me deklaratën *vetting*, subjekti ka paraqitur: (i) Librezën e punës së P. B. nr. {\*\*\*}, ku rezulton se P. B. ka punuar si shofer pranë {\*\*\*}, qyteti Bajram Curri, Rrethi Tropojë, periudha 01.07.1980 – 15.06.1990, dhe si shofer për transport ndërkombëtar të mallrave, në {\*\*\*}, Durrës, në periudhën 09.07.1990 – 16.09.1993. (ii) Vërtetim nr. prot. {\*\*\*}, dt. 24.01.2017, nga ISSH, Dega Tropojë, që konfirmon se në arkivin e saj, në arkivin e Drejtorisë së ISSH-së Kukës dhe në arkivin e DAQ Tiranë nuk disponohen dokumente (bordero, listëpagesa, regjistra etj.) për {\*\*\*} së Rrethit Tropojë, ku ka punuar P. B., në periudhën 1980 – 1990. Komisioni gjatë hetimit administrativ ka administruar: Shkresën nr. {\*\*\*}, dt.12.04.2024, të ISSH-së, Drejtoria e Arkivit Qendror, që konfirmon punësimin e shtetasit P. B., si shofer pranë {\*\*\*},

deklaruara; (ii) nga puna si shofer për transport ndërkombëtar të mallrave pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, Kavajë, dhe firmës “{\*\*\*}”, Tiranë, pasi referuar deklarimit të bashkëshortit, se ka punuar në të zezë, si dhe dokumentacionit të administruar, ka vlerësuar se të ardhurat e krijuara nuk janë të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës; (iii) të përfituara në formën e dietave, pranë shoqërive tregtare “{\*\*\*}” ShA, Tiranë, “{\*\*\*}” ShPK, Lushnjë, pranë “{\*\*\*}” ShPK, Tiranë, duke vlerësuar se të ardhurat e deklaruara me burim nga dietat nuk i plotësojnë kriteret e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

17.2. Të përfshijë në analizën financiare të ardhurat e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit, të deklaruara: (i) nga paga si shofer autobusi në linjën Tiranë – Athinë – Tiranë, pranë shoqërisë tregtare “{\*\*\*}” ShA, Tiranë, në vlerën 523.289 lekë; (ii) nga paga si shofer autobusi në linjën Tiranë – Athinë – Tiranë, pranë shoqërisë tregtare “{\*\*\*}” ShPK, në vlerën 1.406.904 lekë; (iii) nga paga si shofer autobusi në linjën ndërkombëtare turistike, pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, Tiranë, në shumën 876.244 lekë.

18. Subjekti i rivlerësimit pretendon përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të siguruara nga puna e bashkëshortit, sipas deklarimeve të tij, dhe kundërshton konkluzionet e Komisionit, duke parashtruar: (i) Të ardhurat e bashkëshortit janë deklaruar në deklaratat e pasurisë, çfarë i bën ato tërësisht të matshme. (ii) Nuk mund të pretendohet për marrëveshje mes punëdhënësit e punëmarrësit, pas vitit '93, ku mekanizmat shtetërorë nuk funksiononin, për shkak të situatës që kalonte vendi, ishte luks që punëdhënësi të ofronte punë, bashkëshorti ka pranuar të punojë në një biznes të regjistruar konform rregullave, por nuk kishte asnjë fuqi ta detyronte punëdhënësin për regjistrimin e punonjësve dhe, se për shkak të kohës së gjatë të kaluar, është në pamundësi objektive të paraqesë më shumë prova sipas nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016. (iii) Pagesat nëpërmjet sistemit bankar kanë filluar në vitin 2002, prandaj deri në këtë vit të ardhurat nga paga dhe nga dietat janë marrë *cash* nga bashkëshorti, por edhe pas këtij viti, referuar legjislacionit tatimor, nuk ndalohej pagesa e dietave në *cash*. (iv) Referuar parashikimeve të ligjit nr. 8438/1998, të ardhurat nga dietat nuk i nënshtrohen detyrimeve tatimore. (iv) Për natyrën e punës së bashkëshortit dhe vlerësimit në kontekstin e kohës kur dietat janë paguar, për të cilat ka dorëzuar mandate pagese, i ka deklaruar ato si një nga burimet kryesore të krijimit të të ardhurave të familjes në deklaratat vjetore të pasurisë, për vitet 2005 – 2016, shuma e përfutur nga dietat, e cila nuk është përdorur për konsum ushqimor, ka qenë e ardhur reale për familjen, është përdorur për *shpenzime familjare si ushqim, argëtim etj.*, për investim/blerje pasuri të luajtshme dhe është paraqitur në analizën financiare të ekspertes E. O.<sup>9</sup>
19. Trupi gjykues, nga aktet në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e subjektit, vlerëson se përkundër detyrimit kushtetues dhe ligjor, për të vërtetuar me dokumentacion të ardhurat e përfituara si dhe ligjshmërinë e tyre, me dokumentacionin e paraqitur, subjekti i rivlerësimit nuk arriti t'i përmbushë këto detyrime, për të ardhurat e deklaruara nga bashkëshorti në deklaratën *vetting*, për të ardhurat nga dietat dhe në disa raste nga pagat. Analiza dhe përfundimet e trupit gjykues në vijim, nuk përfshijnë të ardhurat e deklaruara të bashkëshortit nga puna si shofer pranë institucioneve shtetërore, {\*\*\*}, qyteti Bajram Curri, Rrethi Tropojë dhe në {\*\*\*}, Durrës, të cilat afektojnë vetëm pasurinë “apartament me sipërfaqe 81 m<sup>2</sup>”, në Elbasan, të krijuar në datën 05.03.1996.

---

qyteti Bajram Curri, Rrethi Tropojë, periudha 01.07.1980 – 15.06.1990, dhe si shofer për transport ndërkombëtar të mallrave në {\*\*\*} Durrës, në periudhën 09.07.1990 – 16.09.1993.

<sup>9</sup> Audituese Ligjore (Eksperte Kontabël e Regjistruar), mbajtëse e licencës nr. {\*\*\*}, datë 28.01.2005.

19.1. Lidhur me të ardhurat nga paga si shofer për transport ndërkombëtar të mallrave, pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, periudha 05.10.1993–13.11.1995, pranë shoqërisë “{\*\*\*}”, periudha 01.03.1996 –17.02.2003, për të cilat deklararon në deklaratën *vetting* se ka punuar “në të zezë”, pra në kushtet e një punësimi të paformalizuar sipas ligjit, trupi gjykues i vlerëson të pabazuara pretendimet e subjektit për t’i konsideruar si të ligjshme këto të ardhura në kuadër të parashikimeve të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Referimi prej subjektit i situatës që kalonte vendi pas vitit ’93, informaliteti i ekonomisë në ato vite, ballafaqimi me konceptin e taksimit mbi të ardhurat në mënyrë të plotë, vetëm pas miratimit të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, nuk i bëjnë ligjërish të vlefshme të ardhurat e deklaruara, e as të provueshme nga pikëpamja faktike këto marrëdhënie punësimi, të cilat nuk figurojnë të pasqyruara as në librezën e punës. Në këto rrethana ligjore dhe faktike, pretendimi i subjektit që këto marrëdhënie punësimi provohen me *deklarata noteriale të punëdhënësve, të cilët deklarojnë se bashkëshorti i subjektit është paguar dhe trajtuar me dieta në vlerën që është deklaruar në deklaratat periodike*, dhe se, për shkak të kohës së kaluar, është në pamundësi të sigurimit të dokumentacionit dhe gjen aplikim të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, vlerësohen të pabazuara. *Së pari*, sipas qëndrimit të konsoliduar të organeve të rivlerësimit, për vlerën e dobët provuese të deklaratave noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit, edhe në këtë rast, ku pavarësisht kohës së gjatë të kaluar, deklaruesit “kujtojnë” dhe deklarojnë pikërisht shumat e të ardhurave të deklaruara prej subjektit, përforcohet dyshimi legjitim se kryerja e këtyre deklarimeve është, më së shumti, një mjet për të favorizuar interesat e subjektit të rivlerësimit, sesa pasqyrim/dëshmi reale e rrethanave për të cilat kryhet deklarimi. *Së dyti*, për sa bashkëshorti ka punuar “në të zezë”, deklaruar ky fakt në deklaratën *vetting*, pohuar prej vetë subjektit edhe në ankim, pretendimi për pamundësi për të siguruar dokumentacion për shkak të kohës së gjatë të kaluar dhe për aplikim të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, është i pakuptimtë dhe përpjekje e subjektit për të përmirësuar situatën e saj. Përpos kësaj, lidhur me mandatet e arkëtimit, të paraqitur prej subjektit si dokumentacion justifikues me deklaratën *vetting*, të cilat i përkasin periudhës 1998 – 2006, konstatohet që nuk plotësojnë as elementet e formës, sipas ligjeve që rregullojnë kontabilitetin, por edhe duke *abstragu* nga ky fakt, siç u analizua më lart, të ardhurat e deklaruara nga puna “në të zezë” nuk e kalojnë testin kushtetues dhe ligjor për ligjshmërinë e tyre.

19.2. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga dietat, përpos mospërputhjes së shifrës prej 113.360 euro, të pretenduar në ankim dhe në Komision,<sup>10</sup> me atë të deklaruar në deklaratën *vetting*, prej 108.320 euro, dhe me atë deklaruar në DPV-të gjatë viteve 2005 – 2016, në total 99.730 euro,<sup>11</sup> me ato që rezultojnë të pasqyruara në dokumentacionin e punëmarrësve, në këndvështrim të verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve të subjektit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

---

<sup>10</sup> Dieta të përfituara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA, në shumën totale 21.860 euro; nga shoqëria “{\*\*\*}”, Lushnjë ShPK, në shumën totale 54.900 euro dhe nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në shumën totale 36.600 euro.

<sup>11</sup> DPV - 2005: 120.000 lekë, shofer në firmën “{\*\*\*}” (linja Tiranë – Athinë – Tiranë); dieta për udhëtim 6.240 euro mesatarisht; DPV- 2006: 120.000 lekë, shofer në firmën “{\*\*\*}”; dieta për udhëtim 7.800 euro mesatarisht; DPV - 2007: 175.872 lekë, paga shofer në firmën “{\*\*\*}”; dieta për çdo udhëtim, për çdo rrugë 60 euro, shuma 7.820 euro; DPV- 2008, paga e bashkëshortit, 336.000 lekë; dietat 5.760 euro mesatarisht; DPV - 2009: paga e bashkëshortit, 336.000 lekë; dietat 9.600 euro; DPV - 2010: paga e bashkëshortit, 336.000 lekë; dietat 10.600 euro; DPV- 2011: paga e bashkëshortit, 336.000 lekë; dietat 10.080 euro; DPV- 2012: paga e bashkëshortit 336.000 lekë; dietat 96.009 euro; DPV- 2013: paga e bashkëshortit, 461.000 lekë; dietat 6060 euro; DPV- 2014: paga e bashkëshortit 234.432 lekë; dietat 3590 euro; DPV- 2015: paga e bashkëshortit, 234.432 lekë; të ardhura nga dieta në euro, nga puna e bërë nga jashtë shtetit, nga bashkëshorti, 10.580 euro; DPV- 2016: të ardhura nga paga si shofer pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, 234.432 lekë; të ardhura nga dieta si shofer, bashkëlidhur vërtetimi, vlera 1.200 euro.

19.2.1. Subjekti, për herë të parë, deklaron të ardhura të bashkëshortit në formën e dietave dhe bakshisheve në DPV-në e vitit 2005 (ku deklaron për herë të parë edhe likuiditete *cash*). Në DPV-të e viteve 2005 – 2016, subjekti deklaron të ardhura të bashkëshortit si shofer, në formën e dietave, në shumën totale 99.730 euro, ndërsa referuar dokumentacionit të depozituar prej saj,<sup>12</sup> rezultojnë në shumën 94.320 euro. Përpos kësaj mospërputhje, konstatohet se: (i) Lidhur me shumën e deklaruara nga subjekti si të përfituara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA, në DPV-të e viteve 2005 dhe 2006, nuk ka një vërtetim të lëshuar nga kjo shoqëri, pranë së cilës bashkëshorti punonte këtë periudhë. Referuar llogarisë bankare të bashkëshortit të subjektit, në Tirana Bank, rezulton se për periudhën shtator – dhjetor 2007, nga kjo shoqëri është kredituar në total shuma prej 2.379 euro, me përshkrim “dieta”, e cila rezulton të jetë e vetmja shumë e përfitur nga dietat që ka kaluar nëpërmjet sistemit bankar. Sipas vërtetimit datë 04.03.2008, të kësaj shoqërie, dietat rezultojnë në shumën 2.820 euro, ndërkohë subjekti i ka deklaruar ndjeshëm në një vlerë më të lartë, prej 7.820 euro. (ii) Në dokumentacionin e lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK konstatohen mospërputhje të shumave për të ardhurat e përfituara në formën e dietave, në vitin 2014, fillimisht pasqyrohen 3.590 euro dhe 3.000 lekë, e më pas 8.320 euro.<sup>13</sup> (iii) Po nga shoqëria e sipërcituar për vitin 2016, vërtetohet shuma e dietave të përfituara prej 12.000 euro, ndërsa në DPV-në e vitit 2016, subjekti dhe bashkëshorti i deklarojnë dietat e përfituara 1.200 euro, ku bashkëshorti, krahas shifrës, deklaron me narrativ “*dymbëdhjetë mijë euro*”.

19.2.2. Referuar deklarimeve të subjektit në DPV-të, si dhe vërtetimeve të pagave të lëshuara nga shoqëritë “{\*\*\*}” ShA, “{\*\*\*}” ShPK, si dhe “{\*\*\*}” ShPK, konstatohet se, përveç vitit 2007, totali vjetor i pagës së bashkëshortit të subjektit është afërsisht 3-4 herë më i vogël se totali i dietave. Ky raport që dëshmon qartë se vlerat e deklaruara, të përfituara si “dieta”, tejkalojnë logjikën ekonomike për t’u trajtuar si të tilla dhe, në çdo rast, nuk mund të mbështeten nga shpjegimet e subjektit, se dietat e përfituara nga bashkëshorti nuk janë dieta mirëfilli, si ato që përfitojnë punonjësit shtetërorë, se në to nuk përfshihen mbulimi i shpenzimeve për fjetje dhe udhëtim, por jepet për shkak të vështirësive të kësaj natyre pune, të jetuarit larg shtëpisë, dëmtimet shëndetësore dhe profesionale etj.

19.2.3. Gjithashtu, referuar dokumentacionit bankar, konstatohet se: (i) Për vitin 2008, totali i pagës vjetore të bashkëshortit të subjektit është kredituar përmes dy (2) veprimeve bankare, prej shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, Lushnjë, në datën 24.12.2008 është kredituar shuma 69.192 lekë, me përshkrimin: “*Pagë muaji mars, prill, maj 2008*” dhe, në datën 30.12.2008, është kredituar shuma 207.576 lekë, me përshkrimin: “*Kaluar pagë për muajt janar, shkurt, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2008, sipas bordersë*”. (ii) Në vitin 2009, paga e të gjithë vitit është kredituar prej shoqërisë në datën 16.12.2009, në një shumë të vetme prej 276.768 lekësh. Këto rrethana faktike përforcojnë bindjen se të ardhurat në formën e dietave kanë përfaqësuar një pjesë të pagës dhe janë përfitur *cash* për çdo udhëtim (sipas deklaramit të vetë subjektit).

19.2.4. Përkundër destinimit për mbulim të shpenzimeve të kryera gjatë udhëtimeve të punës, për nevoja ushqimore dhe fjetje, e në këtë kontekst, të një vlere të arsyeshme për mbulimin e këtyre shpenzimeve, vlera e dietave të deklaruara si të përfituara nga bashkëshorti, për periudhën 2005 – 2016, varion në 2-4 herë më e lartë se paga e tij vjetore, e cila gjatë gjithë kësaj periudhe, përgjithësisht, është në të njëjtën vlerë, kurse vlera e të ardhurave nga dietat rritet. Këto rrethana faktike, si dhe fakti se, në vitin 2008, përmes dy kreditimeve në llogari bankare, ka kaluar shuma e

<sup>12</sup> Vërtetimi “{\*\*\*}” ShA, datë 04.03.2008; vërtetimi nr. {\*\*\*} prot., datë 20.01.2017, lëshuar nga “{\*\*\*}” ShPK Lushnjë, dhe vërtetimi nr. {\*\*\*} prot., datë 24.01.2017, lëshuar nga “{\*\*\*}” ShPK.

<sup>13</sup> Respektivisht në vërtetimin e datës 05.03.2015 dhe në vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 24.01.2017.

pagave të disa muajve njëherësh dhe, në vitin 2009, vlera e pagave të të gjithë vitit është kredituar në një shumë të vetme, krijojnë kuptimin e arsyeshëm që një pjesë e konsiderueshme e pagës është emërtuar “dietë”, duke evituar natyrën e vërtetë të këtyre të ardhurave, si një pjesë e pagës së bashkëshortit, por e padeklaruar në organet tatimore. Në këtë kontekst, edhe pretendimi i subjektit, *se vlera e deklaruar e të ardhurave, krijuar nga dietat e papërdorura për shpenzimet e bashkëshortit, ka qenë një nga burimet kryesore për të ardhurat familjare dhe të krijimit të depozitave bankare*, dëshmon se shumica e dietave ka tejkaluar mbulimin e shpenzimeve të bashkëshortit gjatë udhëtimeve të punës, duke dalë, edhe sipas këtij pretendimi, jashtë natyrës dhe qëllimit për të cilin dietat jepen. Të dhënat si më sipër krijojnë bindjen se bashkëshorti i subjektit ka qenë në kushtet e keqbesimit, duke pranuar që vetëm një pjesë e pagës t’i nënshtrohej tatimit mbi të ardhurat, nëpërmjet dakordësimit me punëdhënësin për shmangien e detyrimeve tatimore, e rrjedhimisht, subjekti nuk mund të shmanget nga pasoja ligjore që krijon kjo sjelljeje në raport me përmbushjen e kriterit të ligjshmërisë për këto të ardhura, sipas një qëndrimi të konsoliduar në jurisprudencën e Kolegjit.<sup>14</sup> Në këto rrethana faktike dhe ligjore, pretendimet e subjektit se, *referuar parashikimeve të ligjit nr. 8438/1998, të ardhurat nga dieta nuk i nënshtrohen detyrimeve tatimore*, përpos të pakuptimita, vlerësohen të pabazuara. Sa më sipër, që vjen si konkluzion logjik nga të dhënat e dokumentacionit të administruar, përforcohet edhe nga shpjegimet e subjektit në Komision, e potencuar edhe në ankim, se dietat e përfituara nga bashkëshorti nuk janë dieta mirëfilli, si ato që përfitojnë punonjësit shtetërorë, se në to nuk përfshihen mbulimi i shpenzimeve për fjetje dhe udhëtim, por jepen për shkak të vështirësive të kësaj natyre pune, të jetuarit larg shtëpisë, dëmtimet shëndetësore dhe profesionale etj., elemente të cilat konsiderohen si rregull në ato që përcaktojnë pagën në një marrëdhënieje punësimi.

19.2.5. Në përmbledhje të arsytimit të shtjelluar më sipër, trupi gjykues, sikurse edhe Komisioni, në funksion të kontrollit të vendimit objekt ankimi, nuk përlloragiti si burim krijimi të pasurive, të ardhurat nga paga, të cilat nuk plotësojnë kriteret kushtetuese dhe ligjore të së ardhurës së ligjshme, si dhe të ardhurat nga “dietat”. Pavarësisht sa arsyetuar më lart, trupi gjykues, në kuadër të shterimit të çdo pretendimi të subjektit të rivlerësimit në këtë proces, vendosi të konsiderojë dietat e përfituara prej tij, për periudhën 2007 – 2016, të cilat vërtetohen me dokumentacion, në vlerën totale prej 94.320 euro, në kuadër të një analize garantiste/alternative. Në vlerësimin për pasuritë në vijim, sipas rastit, trupi gjykues do të reflektojë edhe konsiderimin e të ardhurave nga dietat e bashkëshortit, kur ato kanë një efekt mbi këtë vlerësim.

*Pasuria “apartament banimi me sip. 81 m<sup>2</sup>”, në lagjen “{\*\*\*}”, pallati {\*\*\*}, Elbasan*

20. Në deklaratën vetting, subjekti deklaroi: *Apartament banimi 81 m<sup>2</sup>, gjendur në lagjen “{\*\*\*}”, pallati {\*\*\*}, Elbasan, blerë në dt. 05.03.1996, me kontratën nr. {\*\*\*}, vlera 1.800.000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga shitja e apartamentit 1+1, i gjendur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., dt. 06.03.1996, në vlerën 800.000 lekë, si dhe kredia e marrë pranë BTA, në shumën 500.000 lekë, në datën 12.03.1996, kredi kjo e mbyllur në tetor 2005, pranë ATK (Agjencia e Trajtimit të Kredive, Elbasan). Pjesë takuese 50%.<sup>15</sup>*

<sup>14</sup> Shih ndër të tjera, vendimet e Kolegjit nr. 23/2020 (JR), datë 25.09.2020 dhe nr. 15/2021 (JR), datë 18.06.2021.

<sup>15</sup> Me deklaratën e pasurisë vetting, subjekti ka depozituar: *Vërtetim dt. 11.01.2017, nga ZVRPP Elbasan, që konfirmon se P. B. dhe Rajmonda Berisha kanë në pronësi apartamentin nr. {\*\*\*}, me sip. 81 m<sup>2</sup>, shk. {\*\*\*}, kati {\*\*\*}, në pallatin nr. {\*\*\*}, në lagjen “{\*\*\*}”, në ZK {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, Elbasan; Kontratë shitblerje nr. {\*\*\*} rep./ {\*\*\*} kol., dt. 05.03.1996, me të cilën P. B. dhe Rajmonda Berisha blejnë nga bashkëpronarët D. (L., Xh., L., M. dhe M.),*

21. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk arriti të provojë se burimet për krijimin e kësaj pasurie kanë qenë të krijuara në mënyrë të ligjshme, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion është mbështetur në vlerësimin në lidhje me mundësinë financiare të subjektit për të kursyer shumën 500.000 lekë, për plotësimin e çmimit të blerjes së apartamentit me një balancë negative (-) 155.678 lekë, pasi: (i) pavarësisht se subjekti nuk ka dokumentuar të ardhurat për periudhën 1987 – 31 dhjetor 1994, për një qëndrim garantist, Komisioni ka përllogaritur të ardhurat për vitet 1991 – 1994 referuar nivelit të pagave për gjyqtarët.<sup>16</sup> (ii) Për të ardhurat para viteve 1990, ku vlerat e pagave, për shkak të qenies në nivele të papërfillshme, nuk kanë peshë në konsiderimin e mundësisë për të krijuar kursime, edhe nëse do të merrej në konsideratë pretendimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pagat në vitet 1987 – 1994, që sipas deduksionit rezultojnë të deklaruara në shumën 279.260 lekë, përsëri analiza financiare do të rezultonte me një balancë negative në shumën (-) 92.691 lekë.
22. Subjekti i rivlerësimit pretendon se provat e grumbulluara në kuadër të hetimit administrativ tregojnë për mundësinë e krijimit të shumës 500.000 lekë, për blerje të apartamentit në vitin 1996. Sipas saj: (i) Vlerësimi i Komisionit është jashtë kontekstit ligjor dhe praktikës së kohës kur janë krijuar dhe përdorur të ardhurat, është e papranueshme që analiza financiare të fillojë në vitin 1995, pas 8-9 viteve punë të saj, ajo ka filluar punë prej datës 01.09.1987 dhe deri në 05.03.1996, dhe për këtë periudhë, ka provuar me dokumentacion punësimin, përfitimin e të ardhurave dhe ka krijuar kursime, që tejkalojnë shumën 500.000 lekë, të përdorur për financimin e diferencës së çmimit të blerjes së apartamentit. (ii) Komisioni duhet të përfshinte në hetim administrativ të thelluar edhe periudhën 1987 – 1995, pasi ka shpjeguar vijimin e traditës familjare të kursimit për blerje apartamenti dhe orendi, veçanërisht për familjet e reja, dhe në periudhën e sipërpërmendur, krahasuar me pagat e punonjësve të tjerë, pagat e specialistëve me arsim të lartë kanë qenë rreth dy herë më të larta, dhe kjo bënte që këta të fundit të kursenin rreth 50% të pagës. (iii) Në analizën financiare, në mënyrë të padrejtë, nuk janë përfshirë të ardhurat e siguruara nga bashkëshorti, analiza financiare e paraqitur prej saj në Komision, për periudhën 1987 – 2016, dëshmon mundësitë familjare për të kursyer shumën 500.000 lekë, për plotësimin e çmimit të blerjes së apartamentit. (iv) Edhe nëse do të ekzistonte balanca negative e konstatuar, konkluzioni i Komisionit vjen në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit, pasi diferenca të kësaj natyre nuk janë vlerësuar për asnjë subjekt rivlerësimi.
23. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e subjektit, duke mbajtur në konsideratë kohën e krijimit të kësaj pasurie, datë 05.03.1996, mundësinë e pasjes së të ardhurave të tjera, ndonëse jo të provuara sipas standardeve ligjore të këtij procesi, gjeti të drejtë analizën dhe përllogaritjen e bërë prej Komisionit për kontrollin e kësaj pasurie sipas variantit

---

*apartamentin nr. {\*\*\*}, kati {\*\*\*}, pallati nr. {\*\*\*}, në lagjen “{\*\*\*}”, në vlerën 1.800.000 lekë, e paguar jashtë zyrës noteriale; Kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep./ {\*\*\*} kol., dt. 06.03.1996, me të cilën P. B. dhe Rajmonda Berisha shesin në vlerën 800.000 lekë apartamentin në pronësi të tyre, në pallatin nr. {\*\*\*}, në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, e vërtetuar me vërtetim pronësie datë 16.07.1993, çmimi i shitjes paguar jashtë zyrës noteriale; Plan i amortizimit të kredisë së marrë nga Rajmonda Berisha, në shumën 500.000 lekë, në dt. 12.03.1996, me afat 120 muaj; Plan amortizimi i kredisë me datë rillogaritje 30.06.1996; Vërtetim nr. {\*\*\*} nga BKT, Dega Elbasan, që konfirmon se Rajmonda Berisha nuk ka detyrime pranë kësaj banke në dt. 05.03.1996; Mandat arkëtimi dt. 11.03.1996, i Bankës së Kursimeve, me përshkrimin: “vlera 1.300.000 lekë, për plotësimin e shumës së kontratës nr. {\*\*\*}, dt. 05.03.1996, për blerje shtëpie; Vërtetim nr. {\*\*\*} prot., dt. 05.03.1996, nga Banka Tregtare Agrare (BTA), se Rajmonda Berisha nuk është debitore pranë kësaj banke.*

<sup>16</sup> Bazuar në shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.09.2019, të ZABGj-së.

garantist të referuar në vendim. Në këto kushte, në konsideratë të faktit se balanca negative sipas këtij versioni, në vlerën prej (-) 92.691 lekësh, e cila vjen si rezultat edhe i mospërfshirjes së të ardhurave të bashkëshortit nga puna si shofer pranë institucioneve shtetërore, për të cilat vërtetohet me dokumentacion periudha e punësimit, por jo masa e të ardhurave, është në një masë jodomethënëse përkundrejt vlerës së pasurisë, prej 1.800.000 lekësh, trupi gjykues, në zbatim të parimit të objektivitetit, e gjeti atë si pa peshë për konsiderimin me probleme të krijimit të kësaj pasurie. Për pasojë arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për krijimin e saj dhe konkluzioni i Komisionit, për të kundërtën, nuk është pasojë e vlerësimit të drejtë të të gjithë situatës ligjore dhe faktike, që lidhet me të.

*Pasuria “apartament banimi me sip. 83 m<sup>2</sup>”, në lagjen “{\*\*\*}”, rruga “{\*\*\*}”, Vlorë*

24. Në deklaratën vetting, lidhur me këtë pasuri, subjekti deklaron: “Apartament banimi 83 m<sup>2</sup>, gjendur në lagjen ‘{\*\*\*}’, rr. ‘{\*\*\*}’, Vlorë, sipas kontratës së porosisë datë 21.12.2007, nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol. Pronësia nuk është fituar ende, pasi nuk është realizuar blerja dhe regjistrimi në ZVRPP Vlorë. Vlera 48.000 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Kredi nga Alpha Bank, në shumën 48.000 euro, në datën 30.12.2007. Shlyerja e kredisë ka përfunduar në datën 04.01.2011. Për mbylljen e kredisë u shfrytëzuan depozitat e përbashkëta bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank, Elbasan, në vlerën 23.000 euro, plus 1.500.000 lekë, e barabartë me 10.800 euro, plus cash, në vlerën 1.500.000 lekë, e barabartë me 10.800 euro, si dhe 1.100 euro, të marrë nga paratë e mbartura cash si kursime në shtëpi. Kursimet në shtëpi janë krijuar me pagat e mia dhe kryesisht të bashkëshortit”.<sup>17</sup>
25. Lidhur me këtë pasuri, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, dhe duke çmuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës,<sup>18</sup> Komisioni ka konkluduar se çmimi i pasurisë do të konsiderohet në vlerën 64.000 euro dhe se subjekti ka bërë

<sup>17</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vetting, dokumentet provuese: (i) Kontratë kapari nr. {\*\*\*} rep./ {\*\*\*} kol., dt. 21.12.2007, lidhur mes palës shitëse të ardhshme, Th. B., dhe palës blerëse të ardhshme, subjektit dhe bashkëshortit të saj (bashkëlidhur kontratës janë: vendimi nr. {\*\*\*}, dt. 19.12.2005, i KRrT-së, për sheshin e ndërtimit të pallatit 8-katësh; planimetria e sheshit të ndërtimit; planimetria e sipërfaqeve të apartamenteve); (ii) Depozitë prej 45.700 euro, në arkë, në dt. 04.01.2011, në Alpha Bank, nga P. e Rajmonda Berisha; (iii) Pasqyra e amortizimit të kredisë në Alpha Bank, në shumën 48.000 euro, me afat 20-vjeçar; (iv) Nxjerrje llogari bankare në Alpha Bank, për periudhën 01.12.2007 – 06.02.2009, në emër të Rajmonda e P. B., ku rezulton se, në dt. 28.12.2007, është çelur kredia me vlerë 48.000 euro; në dt. 28.12.2007 është kryer pagesa në shumën 47.644 euro, për “{\*\*\*}” ShPK, për blerje apartamenti; (v) Nxjerrje llogari bankare nga Alpha Bank, për periudhën 01.01.2010 – 31.12.2010, në emër të Rajmonda e P. B.; (vi) Shlyerja kredie, në dt. 04.01.2011, në Alpha Bank, nga P. B., në shumën 43.474 euro; (vii) Nxjerrje llogari bankare, dt. 24.01.2017, nga Intesa Sanpaolo Bank, në emër të P. e Rajmonda Berisha, ku rezulton se, në dt. 3.1.2011, janë maturuar depozitat në shumën totale 1.528.200 lekë (me dy këste, 1.302.319 lekë dhe 225.881 lekë) dhe është tërhequr shuma 1.502.689 lekë; (viii) Vërtetim dt. 25.01.2017, nga Intesa SanPaolo Bank, ku konfirmohet se Rajmonda e P. B. kanë qenë klientë të Bankës Amerikane, me llogari të hapura, në dt. 12.02.2004. Depozitimet fillestare janë në vlerën 500.000 lekë dhe llogaritë e përbashkëta janë në vlerën 3.000 euro. Këto depozita janë mbyllur në dt. 03.01.2011. Bashkëlidhur vërtetimit janë nxjerrje llogari bankare dt. 31.12.2004, në emër të Rajmonda e P. B., të depozitave 500.000 lekë dhe 3.000 euro, dhe rinovimit të tyre dhe në vlerën 10.016 euro; dhe nxjerrje llogari bankare dt. 31.12.2006, në vlerën 1.030.465 lekë dhe në vlerën 15.272 euro.

<sup>18</sup> Lidhur me këtë pasuri, Komisioni i ka kaluar subjektit barrë prove, duket se: (i) ka bërë deklaram të rremë të çmimit të apartamentit, pasi në deklaratën vetting ka deklaruar çmimin 48.000 euro, ndërkohë që në kontratën e kaparit, datë 21.12.2007, palët kanë përcaktuar çmimin 64.000 euro; (ii) ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e apartamentit, në vlerën 64.000 euro, pasi nuk u provua burimi i ligjshëm i shumës 16.000 euro, të paguar si kapar në datën 21.12.2007; (iii) ka mungesë burimesh të ligjshme për shlyerjen e parakohshme të kredisë në vitin 2011, pasi nuk u provua ligjshmëria e burimeve të deklaruara se janë përdorur për shlyerjen e saj.

deklarim të rremë të këtij çmimi në deklaratën *vetting*. Lidhur me mundësitë e krijimit të kësaj pasurie, nga analiza financiare, ka rezultuar se subjekti dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e saj. Konkretisht, në mënyrë të përmbledhur, Komisioni ka vlerësuar si vijon:

- Shpjegimet e subjektit për çmimin 48.000 euro nuk janë bindëse për sa rezulton e provuar: (i) Në lidhje me çmimin e apartamentit dhe pagimin e shumës 16.000 euro, gjatë hetimit administrativ krijoi bindjen se vlera e paguar për apartamentin është 64.000 euro, ndërsa subjekti në prapësime nuk solli ndonjë provë të re për të provuar të kundërtën. (ii) Palët e kanë formalizuar vullnetin e tyre paraprak për shitblerjen e apartamentit në kontratën e kaparit, të bërë para noterit, që ka fuqi të plotë ligjore për gjithçka palët kanë deklaruar në kontratë, mungesa e një kontrate shitblerje nuk e bën të pavlefshme kontratën e kaparit dhe as nuk e zbeh besueshmërinë e kësaj të fundit; deklarata noteriale e shtetasit Th. B., datë 26.01.2021, nuk mund të shfuqizojë kontratën e kaparit në pjesën ku palët deklarojnë se është paguar shuma 16.000 euro, në datën e lidhjes së kontratës së kaparit. (iii) Në vendimin për *kufi kredie e huadhënie* të bankës që ka miratuar një kufi kredie në shumën 48.600 euro, citohet se kostoja e përgjithshme e projektit është në shumën 64.000 euro, ku kontributi i kredimarrësve është 30% ose 19.000 euro dhe i bankës është 70 % ose 45.000 euro. (iv) Këto detaje e rrethana përforcojnë bindjen se palët janë përpara një kontrate kapari të mirëfilltë, në zbatim të së cilës është paguar kësti i parë 16.000 euro si kapar, dhe pagesa e këstit të dytë 48.000 euro, në datën 28.12.2007, përpara datës së caktuar 15.05.2008, ka shmangur mundësinë që pala blerëse e ardhshme (subjekti) të humbasë kaparin e paguar në shumën 16.000 euro, si dhe bëjnë të pabesueshme deklaratën e shtetasit Th. B.

- Nga analiza financiare, subjekti dhe personat e lidhur kanë rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, si për pagimin e shumës 16.000 euro, ashtu edhe për shlyerjen e parakohshme të kredisë në vitin 2011, për të cilën janë përdorur likuiditetet e deklaruara në vite, pasi subjekti nuk arriti të provojë burimet e ligjshme për çeljen e depozitave dhe shtesat e tyre, si dhe krijimin e kursimeve *cash* për shkak të balancave negative.

26. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka bërë deklarim të rremë në deklaratën *vetting*, të çmimit të apartamentit në vlerën 48.000 euro, dhe se nuk ka mungesë burimesh të ligjshme për shlyerjen e parakohshme të kredisë në vitin 2011. Sipas saj:

*i. Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit:* Në ankim, subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit, për të mos vlerësuar bindëse shpjegimet e saj është joobjektiv dhe i pabazuar në prova, nuk ekziston asnjë kontratë shitblerje, që provon të kundërtën e sa deklaruar prej saj, lidhur me çmimin e blerjes, pasi *shitësi* nuk i ka përfunduar procedurat ligjore për kolaudimin e objektit dhe marrjen e lejes së shfrytëzimit të tij. Deklarimi në DPV-në e vitit 2007 provon se kredia është marrë në vlerën 48.000 euro dhe apartamenti është blerë në të njëjtën vlerë, e po ashtu, deklarimi i saj në ILDKPKI, në vitin 2016, në përgjigje të pyetjeve të bëra nga ky institucion, konsiderohen prova në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, që provojnë blerjen e apartamentit në vlerën 48.000 euro. Provat dokumentare, provat me dëshmitarë, deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.01.2021, e shtetasit Th. B., shpjegimet e saj në Komision, që përputhen plotësisht me përmbajtjen e akteve, provojnë se shuma 16.000 euro nuk është paguar asnjëherë, shënimi i kësaj shume në kontratën e kaparit nuk provon pagesën e saj. Duke vlerësuar të konsiderojë çmimin e blerjes 64.000 euro, Komisioni e ka ngarkuar me barrë prove për diçka të paqenë, pasi, referuar parashikimeve ligjore në fuqi, nuk ekziston detyrimi për provueshmërinë e burimit të shumës 16.000 euro, që nuk

është paguar asnjëherë. Komisioni nuk ka kryer asnjë hetim administrativ të thelluar në shoqërinë e ndërtimit “{\*\*\*}” (pala shitëse), në lidhje me regjistrimin kronologjik në ditar dhe në llogari të veprimit të arkëtimit të shumës 16.000 euro, dhe nuk ka asnjë referencë të dokumentacionit ligjor, që të vërtetojë se kjo shumë është paguar prej subjektit.

Në parashtrime, duke iu referuar kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.10.2025, subjekti potencon se, sipas çmimit të shitblerjes në kontratë, vlera e blerjes së apartamentit është 48.000 euro, sipërfaqja e tij 67 m<sup>2</sup>, fakt që provon tërësisht vërtetësinë e deklarimeve të saj, periodike dhe në deklaratën vetting, se nuk ka pasur deklarim fiktiv të çmimit të shitjes apo blerjes së pasurisë, dhe se kontrata e kaparit nuk është ekzekutuar kurrë.

ii. Lidhur me shlyerjen e parakohshme të kredisë në vitin 2011, subjekti pretendon se të ardhurat kanë qenë të mjaftueshme, pasi provohet ligjshmëria e krijimit të tyre. Sipas saj, vlera 22.979,6 euro e tërhequr nga Intesa Sanpaolo Bank, në datën 03.01.2011, ka si burim depozitat e maturuara në shumat 17.553,77 euro dhe 5.425,83, të gjeneruara nga depozita fillestare prej 3.000 euro, e krijuar në datën 12.04.2004, e shtuar me depozitime në vitin 2004 dhe 2006, si dhe nga interesat e gjeneruara në vite, për të cilat Komisioni ka bërë analizë të fragmentuar, dhe nuk ka përfshirë të ardhurat e bashkëshortit nga puna si shofer pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në vitet 1993 – 1995, dhe shoqërisë “{\*\*\*}”, Tiranë , në vitet 01.03.1996 – 17.02.2003.

27. Trupi gjykues, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit dhe kërkimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në ankim, në funksion të kontrollit të konkluzionit të Komisionit për pasurinë “apartament”, në Vlorë, blerë në vitin 2007, konstaton dhe vlerëson si vijon.

*Lidhur me vlerën e paguar prej subjektit për blerjen e kësaj pasurie*

27.1. Kjo pasuri deklarohet për herë të parë prej subjektit në DPV-në e vitit 2007, përmes deklaramentit në formularin e detyrimeve: “Kredi bankare e marrë nga banka ‘Alfa Bank’, në shumën 48.000 euro, për blerje shtëpie me të njëjtën vlerë. Miratuar më datë 28.12.2007, me afat 20 vjet, me këst mujor 316.3 euro. Interesi 5%, nr. i llogarisë {\*\*\*}. Kontrata e blerjes datë 21.12.2007, nr. rep. {\*\*\*}, kol. {\*\*\*}; kontrata e kredisë {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol. Në emër edhe të bashkëshortit. Shlyerja ka filluar në datën 28.01.2008”. Në DPV-të e viteve 2008, 2009 dhe 2010, subjekti deklaroi interesat vjetorë të paguar të kredisë prej 48.000 euro,<sup>19</sup> dhe në DPV-në e vitit 2011 deklaroi likuidimin e pjesës së mbetur të kredisë, në shumën prej 43.474,32 euro, pagesa para afatit 2.173,64, totali 45.674,96 euro.

27.2. Me deklaratën vetting, ku kjo pasuri deklarohet prej subjektit në vlerën 48.000 euro, si dokumentacion ligjor është paraqitur “Kontratë kapari” me nr. {\*\*\*} rep, nr. {\*\*\*} kol., datë 21.12.2007<sup>20</sup>. Referuar këtij akti, me palë shitëse të ardhshme, Th. B., palë blerëse të ardhshme, subjekti dhe bashkëshorti, pasqyrohet se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka filluar ndërtimin e një godine mbi truallin në pronësi të shtetasit Th. B. dhe se palët në kontratë kanë rënë dakord për shitjen e një apartamenti të tipit “B-3” të përbërë “1+1”, në katin e tetë nga toka, sipas skicës bashkëlidhur, kundrejt një çmimi prej 64.000 euro. Sipas kontratës, pala marrëse e kaparit dhe shitëse e ardhshme, zoti Th. B, dhe blerësi i ardhshëm kanë rënë dakord që ky i fundit të blejë apartamentin me pagesë të

<sup>19</sup> Respektivisht: 3.545,61 euro, 4.195 euro dhe 3.974,50 euro.

<sup>20</sup> Bashkëlidhur janë vendimi nr. {\*\*\*} dt. 19.12.2005 i KRRT për sheshin e ndërtimit të pallatit 8 katësh; planimetria e sheshit të ndërtimit; planimetria e sipërfaqeve të apartamenteve

çmimit që bëhet në dy këste, në datën e nënshkrimit të kontratës është likuiduar shuma prej 16.000 euro dhe brenda datës 15.02.2008 do të likuidohet shuma prej 48.000 euro, çmimet e kontraktuara në kontratë janë fikse dhe të pandryshueshme, në rast se pala blerëse e ardhshme nuk shlyen këstin edhe pas tre muajsh nga data e caktuar në kontratë, palës shitëse të ardhshme i lind e drejta të kontraktobjë shitjen e apartamentit të persona të tretë, dhe pala blerëse e ardhshme do të humbasë plotësisht shumën e paguar si këst të parë. Sipas akordit të palëve, palës blerëse të ardhshme do t'i dorëzohet apartamenti i përfunduar brenda datës 31.08.2008, kontrata e shitjes përfundimtare të kryhet në momentin e regjistrimit të kësaj pasurie pranë ZVRPP-së Vlorë, në favor të palës shitëse të ardhshme, dhe në rast se kontrata e shitjes, pas regjistrimit të pasurisë në favor të palës shitëse të ardhshme nuk do të realizohet për faj të kësaj të fundit, ajo do të detyrohet t'i kthejë palës blerëse të ardhshme shumën e marrë si kapar plus 20% të shumës.

27.3. Referuar dokumentacionit të Alpha Bank konstatohet: (i) Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 24.11.2007, për kufi kredie e huadhënie, banka ka miratuar dhënien e kredisë për subjektin dhe bashkëshortin në shumën 48.600 euro,<sup>21</sup> për blerje apartamenti me sip.78 m<sup>2</sup>, ndodhur në Vlorë, në pronësi të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, i vlerësuar prej bankës në shumën 70.200 euro, kostoja e përgjithshme e projektit përcaktohet 64.000 euro, kontributi i kredimarrësve 19.000 euro (30%) dhe kontribut i bankës 45.000 euro (70%). (ii) Me “Kontratë hipoteke” nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.12.2007, e cila parashikohet si pjesë përbërëse dhe e pandarë e kontratës së kredisë cituar më lart, lidhur mes Alpha Bank dhe “{\*\*\*}” ShPK, rezulton se *hipotekuesi* (në këtë cilësi ka nënshkruar administratori i firmës, S. A.) ka vënë në dispozicion të bankës hipotekën mbi pasurinë “apartament me sipërfaqe totale 78 m<sup>2</sup>”, ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, e regjistruar në ZVRPP Vlorë, në regjistrin provizor të karabinasë me nr. {\*\*\*}, datë 16.10.2007, dhe banka ka të drejtë të procedojë duke e vënë në ekzekutim të detyrueshëm hipotekën mbi pasurinë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, në rast se *kredimarrësit* nuk paguajnë kredinë, interesat dhe detyrimet e tjera. Kredia me vlerë 48.000 euro është disbursuar në datën 28.12.2007 dhe, po në të njëjtën ditë, bashkëshorti i subjektit i ka transferuar shoqërisë së ndërtimit, “{\*\*\*}” ShPK, shumën 47.644 euro, me përshkrimin: “Sa kaluar nga P. B. në favor të {\*\*\*} ShPK për blerje apartamenti”.

27.4. Sa më sipër, *së pari*, duke abstraguuar nga mospërputhja e ekstremiteve të aktit noterial/kontratë kapari (nr. i repertorit dhe i koleksionit), në DPV-në e vitit 2007 dhe në deklaratën *vetting*, ku akti deklarohet si *kontratë porosie*, trupi gjykues konstaton se në DPV-në e vitit 2007, të dorëzuar në datën 05.03.2008, pra pasi subjekti kishte shlyer dy (2) këstet e përcaktuara në kontratën e kaparit, subjekti e deklaroi *kontratë blerje*, duke dëshmuar se e konsideronte të fituar të drejtën e pronësisë mbi sa ishte dakordësuar dhe paguar sipas parashikimeve në të. *Së dyti*, në vështrim të nenit 681 të Kodit Civil,<sup>22</sup> parashikimet e kontratës së kaparit tregojnë se qëllimi i synuar prej palëve ka qenë pikërisht kalimi i pronësisë te pala blerëse, P. dhe Rajmonda Berisha, përmes shprehjes së vullnetit për tjetërsimin e sendit të paluajtshëm, me sipërfaqe dhe karakteristika të përcaktuara në dokumentet aneks të kontratës, përkundrejt një çmimi konkret, pra kanë përcaktuar kushtet thelbësore që përmban një kontratë shitblerje e një sendi të paluajtshëm. Gjithashtu, në vështrim të nenit 601 të Kodit Civil,<sup>23</sup> si dhe në konsideratë të qëndrimit të Gjykatës së Lartë: “...Kapari është një ndër mjetet

<sup>21</sup> Banka ka miratuar 45.000 euro për blerjen e apartamentit, Visa Card 3.000 euro dhe overdraft me limit 600 euro.

<sup>22</sup> “Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës.”

<sup>23</sup> “Kapar quhet shuma në të holla që njëra nga palët i jep tjetrës për llogari të shumës që do t'i paguhet në bazë të kontratës, me qëllim që të vërtetohet lidhjen e kontratës dhe të sigurojë ekzekutimin e saj.”

e sigurimit të përmbushjes së detyrimeve që, në ndryshim nga të tjerët, siguron jo vetëm përmbushjen e detyrimit, por edhe vetë lidhjen e kontratës”,<sup>24</sup> deklaratat noteriale të shtetasit Th. B., ajo e depozituar në Komision, si dhe ajo e paraqitur me parashtrimet në Kolegj, ku ndryshimi i qëndrimit të deklaruesit shkon në favor të situatës së pretenduar prej subjektit, nuk zhbëjnë kushtet thelbësore të përcaktuara në kontratën e kaparit dhe të konfirmuara me nënshkrimin e palëve para noterit, ndër të tjera, çmimin e apartamentit prej 64.000 euro dhe pagesën e likuidimit të kësaj të parë prej 16.000 euro.

27.5. Në bazë të kontratës së kaparit, në të cilën parashikohet se *çmimet në këtë kontratë janë fikse dhe të pandryshuara*, dhe pas shlyerjes së çmimit të përcaktuar në të, 16.000 euro, likuiduar shtetasit Th. B. dhe 45.000 euro, shoqërisë ndërtuese, subjekti e ka poseduar pronën “apartament”, të cilin e deklaron si vendqëndrim tjetër vetëm në DPV-në e vitit 2016, të dorëzuar në ILDKPKI, më 25.03.2017, pra pasi kishte dorëzuar në këtë institucion deklaraten *vetting*.

27.6. Në dokumentacionin e përcjellë nga ILDKPKI-ja<sup>25</sup> rezulton një korrespondencë me postë elektronike, ndërmjet një punonjëse të këtij institucioni dhe subjektit, në adresën e saj private, në janar 2016, me lëndë “Kontrata”. E pyetur për të saktësuar vlerën e blerjes së apartamentit në Vlorë, është 48.000 euro apo sipas kontratës së kaparit, 64.000 euro, subjekti përgjigjet: [...] *...lidhur me vlerën e ndryshuar nga kontrata e porosisë tek vlera që kam marrë kredi në bankë, sqaroj se kur merr një kredi në bankë funksionon se duhet të kërkosh një vlerë më të madhe se ajo që do, për shkak se banka nuk ta jep 100% të vlerës, kështu që morëm 70 % të saj, por vlera është 48.000 euro, sa unë i kam shlyer edhe bankës. [...]*. Nga aktet në dosje nuk rezulton asnjë e dhënë se në kuadër të cilit proces i është adresuar kjo çështje subjektit prej ILDKPKI-së dhe as në zbatim të cilës dispozitë ligjore është institucionalizuar ky komunikim. Në këtë kontekst, referuar edhe formës si është kryer ky komunikim, trupi gjykues vlerëson se ai nuk përmbush rekuizitat që kërkon neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për të konsideruar si provë deklaratat periodike të subjekteve në ILDKPKI, për pasojë, e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit, se ky shpjegim përbën provë në kuptim të kësaj dispozite.

27.7. Për gjithë sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se vlera e paguar prej subjektit për blerjen e kësaj pasurie është çmimi i përcaktuar në “Kontratë kapari” nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.12.2007, prej 64.000 euro, ku shuma prej 16.000 euro është paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës, sikundër deklaruar prej palëve. Trupi gjykues vlerëson se dokumentacioni i paraqitur prej subjektit, i hartuar pas marrjes së vendimit të shkarkimit të saj, mbi të cilin ajo synon të mbështesë pretendimin se çmimi i paguar për këtë pasuri është 48.000 euro, nuk arrin të bindë trupin gjykues për vërtetësinë e deklarimeve të bëra në të dhe nuk zhbën faktet që deklarohen në kontratën e kaparit.

27.8. Megjithatë, në një vlerësim objektiv dhe tërësor të rrethanave faktike dhe ligjore, trupi gjykues çmon se nuk mund të konkludohet se subjekti ka bërë deklaram të rremë lidhur me çmimin e deklaruar

---

<sup>24</sup> Gjykata e Lartë, me vendimin nr. {\*\*\*} i regi., nr. themeltar {\*\*\*} i vendimit ({\*\*\*}), datë 10.10.2013, ka arsyetuar se: “... në vështrim të përmbajtjes së neneve 601 dhe 602 të Kodit Civil, kapari ka një funksion të dyfishtë: (i) të vërtetojë lidhjen e kontratës dhe (ii) të sigurojë përmbushjen e saj. Në këtë drejtim, kapari konfirmon qenien e kontratës (arrha confirmatoria), që për rastin në shqyrtim konfirmon qenien e kontratës së datës 15.02.2005, prej së cilës palët kanë tërhequr të drejtat dhe kanë marrë përsipër detyrime konkrete. ... Kapari është një ndër mjetet e sigurimit të përmbushjes së detyrimeve që, në ndryshim nga të tjerët, siguron jo vetëm përmbushjen e detyrimit, por edhe vetë lidhjen e kontratës”.

<sup>25</sup> Në përgjigje të shkresës së Komisionit me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.02.2021, “Kërkesë për informacion dhe dokumentacion”, me nr. {\*\*\*}, datë 11.03.2021, është administruar përgjigja dhe dokumentacioni i përcjellë prej ILDKPKI-së.

të kësaj pasurie, sa kohë që kontrata e shitblerjes është lidhur pas plotësimit të deklaratës *vetting*, dhe çmimi i përcaktuar në të është ai që pretendon subjekti, trupi gjykues nuk mund të ketë një qëndrim përfundimtar për arritjen prej palëve të një konkluzioni të ndryshëm nga ai i projektuar me lidhjen e kontratës së kaparit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.12.2007. Pavarësisht këtij qëndrimi, subjekti nuk arriti të provojë që pagesa e shumës prej 16.000 euro nuk është kryer në kohën e lidhjes së kontratës së kaparit, siç palët kanë nënshkruar në të, dhe se pagesa e vetme e kryer për llogari të kësaj pasurie është ajo e përfituar nëpërmjet kredisë bankare. Për pasojë, subjekti gjendet në situatën e mungesës së provueshmërisë në mënyrë shteruese të deklarimit për çmimin e paguar për fitimin e pronësisë.

27.9. Lidhur me mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie me burime financiare të ligjshme, trupi gjykues konstaton se balanca negative e Komisionit për pagesën e kësaj të parë, prej 16.000 eurosh, konfirmohet edhe nga kontrolli i kryer prej Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, për pasojë, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

#### *Lidhur me shlyerjen e parakohshme të kredisë bankare pranë Alpha Bank*

27.10. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaron shlyerjen e parakohshme të kredisë pranë Alpha Bank, në datën 04.01.2011, me burime: (i) depozitat e përbashkëta bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank, Elbasan, në vlerën 23.000 euro dhe 1.500.000 lekë, e barabartë me 10.800 euro; (ii) *cash* 1.500.000 lekë e barabartë me 10.800 euro dhe 1.100 euro nga paratë e mbartura *cash* si kursime në banesë. Kursimet në shtëpi janë krijuar nga pagat e mia dhe kryesisht të bashkëshortit. Ky deklarim bëhet prej subjektit edhe në DPV-në e vitit 2011, ku deklarohet edhe shuma e likuiduar për pjesën e pashlyer të kredisë prej 45.674,96 euro.

27.11. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit, *se nuk arriti të provojë burimet e ligjshme për çeljen e depozitave dhe shtesat e tyre, si dhe krijimin e kursimeve cash për shkak të balancave negative*, me pretendimet se për krijimin e këtyre depozitave, Komisioni ka bërë analizë të fragmentuar dhe se nuk ka përfshirë të ardhurat e bashkëshortit nga puna si shofer pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në vitet 1993 – 1995, dhe shoqërisë “{\*\*\*}”, Tiranë, në vitet 01.03.1996 – 17.02.2003.

27.12. Lidhur me shlyerjen e parakohshme të kredisë bankare, burimi i dytë i financimit për krijimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 83 m<sup>2</sup>”, në Vlorë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për ligjshmërinë e burimeve financiare, të cilat kryesisht konsistojnë në pretendime për ligjshmërinë e të ardhurave të bashkëshortit nga pagat, dietat dhe bakshishet, u vlerësuan prej trupit gjykues të pabazuara. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shlyerjen e parakohshme të kredisë në vitin 2011, duke u gjendur edhe në këtë moment në një situatë financiare që ndikon analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për këtë vit. Analiza e trupit gjykues si vijon.

*Lidhur me depozitat e përbashkëta bankare në Intesa Sanpaolo Bank, në vlerën 22.979,6 euro dhe 1.502.689 lekë, tërhequr në datën 03.01.2011*

27.13. *Së pari*, nga dokumentacioni i administruar nga Intesa Sanpaolo Bank<sup>26</sup> rezulton se në datën 03.01.2011 janë mbyllur prej bashkëshortit të subjektit:

(i) Depozitat dyemërore, respektivisht në shumat 17.553,77 euro dhe 5.425,83 euro, totali i të cilave përbën shumën 22.979,6 euro. Depozita me vlerë 17.553,77 euro është gjeneruar nga depozita fillestare e krijuar në datën 12.02.2004, në shumën 3.000 euro, shtuar me shumat 7.000 euro, në datën 29.06.2004 dhe 5.000 euro, në datën 03.02.2006, dhe interesat e përfituara ndër vite. Depozita me vlerë 5.425,83 euro ka si burim depozitim *cash* të shumës 5.000 euro, në datën 10.12.2007 dhe interesat bankare.

(ii) Depozitat dyemërore, respektivisht në shumat 1.276.808 lekë<sup>27</sup> dhe 225.881 lekë, totali i të cilave përbën shumën 1.502.689 lekë. Depozita me vlerë 1.276.808 lekë është gjeneruar nga depozita fillestare e krijuar në datën 12.07.2004, në shumën 500.000 lekë, shtuar me shumën 500.000 lekë, në datën 03.02.2006; dhe interesat e përfituara ndër vite. Depozita me vlerë 225.881 lekë ka si burim depozitim *cash* të shumës 200.000 lekë në datën 10.12.2007, si dhe interesat bankare.

27.14. Lidhur me pretendimin e subjektit, se pamundësia financiare për krijimin e depozitave vjen për shkak të mospërfshirjes së të ardhurave të bashkëshortit nga puna si shofer pranë shoqërive “{\*\*\*}”, në vitet 1993 – 1995, dhe “{\*\*\*}”, Tiranë, në vitet 01.03.1996 – 17.02.2003, trupi gjykues ka analizuar gjerësisht më lart në këtë vendim, duke e gjetur këtë pretendim të pabazuar. Për pasojë, pretendimi i subjektit për përfshirjen e tyre në analizën financiare për kontrollin e krijimit të depozitave, vlerësohet po ashtu i pabazuar.

27.15. Gjithashtu, edhe pretendimi i subjektit për të ardhura të mjaftueshme financiare edhe për depozitimet të kryera në vite, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar. Konkretisht, për depozitimet e kryera *cash* në bankë, në datën 03.02.2006, shumat 5.000 euro dhe 500.000 lekë, për të cilat nuk ishte deklaruar burim krijimi, trupi gjykues vlerëson të drejtë dhe të bazuar qëndrimin garantist të Komisionit, sipas të cilit, edhe prej konsiderimit si burim krijimi të këtyre depozitimeve, të kursimeve *cash* të deklaruara në DPV-në e vitit 2005, prej 700.000 lekësh, kjo vlerë rezulton më e vogël se totali i depozitimeve *cash*, e për më tepër, në vitin 2005, sipas analizës financiare të Komisionit, kontrolluar në Kolegj, subjekti dhe bashkëshorti kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurive, likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve. Për rrjedhojë, kjo situatë jo vetëm cenon ligjshmërinë e kursimeve *cash* të deklaruara në DPV-në e vitit 2005, por provon plotësisht se subjekti dhe personi i lidhur nuk kishin mundësi për krijimin e depozitimeve *cash*, në vitin 2006, me burime financiare të ligjshme.

27.16. Lidhur me pretendimet e subjektit për kryerjen e analizës financiare në mënyrë të fragmentuar, gjithashtu, vlerësohen prej trupit gjykues të pabazuara. *Së pari*, për mundësitë e krijimit të depozitave në vitin 2004, kryerja e analizës financiare për periudhën 01.01.2004 – 12.02.2004 është e bazuar për sa, në DPV-në e vitit 2003, subjekti nuk deklaroi kursime të mëparshme/gjendje likuiditetesh *cash*.

<sup>26</sup> *Kthim përgjigje datë 25.01.2017, drejtuar subjektit dhe bashkëshortit të saj, dhe shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 16.03.2021.*

<sup>27</sup> *Kjo depozitë është maturuar në datën 03.01.2011, në shumën 1.302.319 lekë, pas pagimit të shumës prej 25.511 lekësh, për prishje depozite përpara afatit, shuma në momentin e mbylljes ishte 1.276.808 lekë.*

Për shumat e depozituara në vijim, si për krijim të depozitave apo shtim të tyre, analiza financiare e kryer nuk ka përfshirë periudhat për të cilat subjekti dhe personi i lidhur kanë rezultuar me balancë negative për shkak të krijimit të pasurive apo likuiditeteve të tjera. Për më tepër, edhe duke *abstraguar* nga fakti se analiza financiare i korrespondon datës së krijimit/shtimit të depozitave, konstatohet se në vitet respektive, subjekti dhe personi i lidhur rezultojnë me pamundësi të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e pasurive, shtimin e likuiditeteve dhe përballimin e shpenzimeve të tjera, edhe në një analizë të kryer për të gjithë vitin kalendarik. Për rrjedhojë, edhe në këtë këndvështrim, pretendimet e subjektit, se balanca negative vjen edhe për shkak të fragmentimit të analizës financiare, vlerësohen të pabazuara.

27.17. Për sa më sipër, edhe pas kontrollit të analizës financiare të Komisionit, nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, balancat negative konfirmohen. Subjekti dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve të ligjshme financiare: (i) për krijimin/shtimin e depozitave në vitin 2004, me një balancë negative prej (-) 1.484.415 lekësh<sup>28</sup>; (ii) për shtimin e depozitave në datën 03.02.2006, me shumat 5.000 euro dhe 500.000 lekë, pasi për krijimin e tyre janë të pamjaftueshme si të ardhurat e subjektit dhe personit të lidhur, për periudhën 01.01.2006 – 03.02.2006, ashtu edhe gjendja e likuiditeteve *cash* të deklaruar në DPV-në e vitit 2005, edhe nëse ato të ishin krijuar me burime të ligjshme; (iii) për krijimin e depozitave në datën 10.12.2007, në shumat 5.000 euro dhe 200.000 lekë, pasi rezultojnë me balancë negative për vitin 2007, por edhe në variantin e konsiderimit të likuiditeteve *cash* të deklaruar në DPV-në e vitit 2006, balanca negative e këtij viti cenon ligjshmërinë e *cash*-it të deklaruar, për pasojë, afekton edhe ligjshmërinë e likuiditeteve që kanë furnizuar depozitat në këtë vit.

*Lidhur me gjendjen cash, 1.500.000 lekë (10.800 euro) dhe 1.100 euro*

27.18. Komisioni ka vlerësuar se gjendja *cash* e deklaruar në deklaratën *vetting*, si një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie, nuk mund të shërbejë si një burim i ligjshëm për mbylljen e kredisë, për shkak të balancave negative të analizës financiare në vitet 2005 – 2010.

27.19. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur burime të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash*. Sipas saj: (i) po të përfshihen në analizën financiare të ardhurat nga puna e bashkëshortit, provohet mundësia për krijimin e gjendjes *cash* me burime të ligjshme;<sup>29</sup> (ii) ka deklaruar në deklaratat e pasurisë, të cilat përbëjnë provë në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, kursimet nga dietat e përfituara nga puna pranë shoqërive tregtare dhe bakshishet; (iii) gjendja e *cash*-it, e deklaruar në datën 31.12.2010, në shumën 2.000.000 lekë dhe 10.800 euro, është më se e mjaftueshme për të mbuluar vlerën e përdorur për shlyerjen e kredisë prej 1.500.000 lekësh dhe 1.100 euro.

27.20. Trupi gjykues, nga aktet në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e subjektit, konstaton dhe vlerëson si vijon. *Së pari*, në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: “*Likuiditet në lekë, gjendje në shtëpi, në shumën 2.000.000 lekë*” dhe “*Likuiditet në euro, gjendje në shtëpi, në shumën*

---

<sup>28</sup> Krijimin e depozitës 3.000, në datën 12.02.2004, për shkak të balancës negative në shumën (-) 298.772 lekë; shtesën e depozitës 7.000 euro, në datën 29.06.2004, për shkak të balancës negative në shumën (-) 726.367 lekë, si dhe krijimin e depozitës 500.000 lekë, në datën 12.07.2004, për shkak të balancës negative në shumën (-) 459.276 lekë.

<sup>29</sup> Konkretisht, subjekti referon për të ardhura të bashkëshortit pranë shoqërive: “{\*\*\*}” ShA, ku për periudhën 2005 – 2007 ka përfitur sipas viteve 6.240 euro, 7.800 euro dhe 7.820 euro; “{\*\*\*}” ShPK, ku për periudhën 01.02.2008 – 28.02.2013 ka përfitur vlerën 54.900 euro; “{\*\*\*}” ShPK, ku për periudhën 04.04.2013 – 31.12.2016 ka përfitur vlerën 36.600 euro.

10.800 euro”, për të cilat në të kundërt me sa pretendon në ankim, nuk deklaroi burim krijimi. Gjatë hetimit administrativ, si edhe në ankim, subjekti pretendon se likuiditetet *cash* janë kursimet nga dietat e përfituara nga puna e bashkëshortit pranë shoqërive tregtare, si dhe bakshishet. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, për periudhën 2005 – 2010, përpara shlyerjes së kredisë, datë 04.01.2011, të gjitha vitet rezultojnë me balanca negative, që pamundësojnë krijimin e gjendjes *cash* me burime të ligjshme. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi për krijimin e likuiditeteve *cash* të deklaruara si burim për shlyerjen e parakohshme të kredisë bankare pranë Alpha Bank. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirje në analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortit nga puna, trupi gjykues, për sa analizuar në detaj më lart në këtë vendim, rithekson se e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për përfshirje në analizën financiare të të ardhurave të dokumentuara dhe që plotësojnë kriterin kushtetues të së ardhurës së ligjshme. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i subjektit vlerësohet prej trupit gjykues, i pabazuar.

27.21. Në përfundim, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për ligjshmërinë e burimeve financiare, me të cilat ka shlyer para kohe kredinë e përdorur për krijimin e pasurisë “*apartment me sipërfaqe 83 m<sup>2</sup>”, në Vlorë*, të cilat kryesisht konsistojnë në pretendime për ligjshmërinë e të ardhurave të bashkëshortit nga pagat, dietat dhe bakshishet, u vlerësuan prej trupit gjykues të pabazuara. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shlyerjen e parakohshme të kredisë në vitin 2011, duke u gjendur edhe në këtë moment në një situatë që afekton analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për këtë vit. Trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për të paguar kaparin në shumën 16.000 euro, në datën 21.12.2007, si dhe për shlyerjen e parakohshme të kredisë në vitin 2011, duke u gjendur kështu në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*Pasuria “likuiditete cash”, në vlerën 1.300.000 lekë*

28. Me pretendimet e saj, lidhur me përfshirjen në analizën financiare të likuiditeteve *cash*, të deklaruara si burim krijimi i shlyerjes së kredisë bankare, subjekti i rivlerësimit ndërlidh edhe pretendimin se likuiditetet *cash*, të deklaruara në deklaratën *vetting*, në shumën 1.300.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga pagat, kursimet dhe përfitimet nga puna e bashkëshortit, në formën e dietave dhe bakshisheve, janë krijuar me të ardhura të ligjshme. Trupi gjykues, duke konstatuar se edhe analiza financiare e Komisionit, për periudhën 2005 – 2016, subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë negative në vlerën (-) 15.253.787 lekë, balancë e konfirmuar edhe nga kontrolli që iu bë kësaj analize prej Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, duke ritheksuar se subjekti ka dështuar të provojë ligjshmërinë e të ardhurave të bashkëshortit nga dietat dhe bakshishet, e vlerëson të pabazuar pretendimin për mundësi financiare të krijimit me të ardhura të ligjshme të gjendjes *cash*, të dekluarar në deklaratën *vetting*. Për pasojë, lidhur me këto likuiditete *cash*, në vlerën prej 1.300.000 lekësh, deklaruar në deklaratën *vetting*, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e saj, duke u gjendur kështu në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*Pasuria “automjet” tip “Mercedes-Benz CDI”, me targë {\*\*\*}*

29. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaroi: *Automjet i markës “Mercedes-Benz CDI”, me targë {\*\*\*}, regjistruar në emër të bashkëshortit. Blerë në datën 29.04.2009, me nr. {\*\*\*} rep. Vlera 1.450.000 lekë. Pjesa që zotëron 50%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga shitja e mjetit “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, në datën 15.10.2009, në shumën 900.000 lekë, sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., si dhe kursimet nga pagat e përbashkëta.*
30. Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës<sup>30</sup> dhe, në analizë të fakteve dhe provave të administruara, në mënyrë të përmbledhur, ka çmuar se: (i) Subjekti në prapësime ka dhënë të tjera burime krijimi për krijimin e kësaj pasurie dhe nuk përmend më të si të tilla të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {\*\*\*}, prapësimet se gjendja e kursimeve të deklaruara në fund të çdo viti provon disponim të ardhurash të mjaftueshme për blerjen e automjetit me targë {\*\*\*}, edhe pa përfshirë në datën përkatëse të blerjes vlerën e automjetit që ka shitur po atë vit, vë në dyshim, për të disatën herë, vërtetësinë e çdo deklarimi e shpjegimi të bërë në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë dhe tregon pasigurinë e subjektit, për provueshmërinë bindëse të burimit të deklaruar në deklaratën *vetting* dhe pyetësorin standard. (ii) Në lidhje me konstatimin *se ka bërë deklaram të rremë* për të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {\*\*\*}, në datën 15.10.2009, si burim krijimi i pasurisë “automjet” me targë {\*\*\*}, në datën 29.04.2009, shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi ky burim nuk ka ekzistuar në momentin e krijimit të kësaj pasurie. (iii) Shpjegimet e subjektit se nuk ka bërë deklaram fiktiv të çmimit të blerjes dhe atij të shitjes së automjetit {\*\*\*}, nuk janë bindëse. (iv) Ndryshe nga sa pretendon subjekti, në analizën e kryer në rezultatet e hetimit janë përfshirë të ardhurat e bashkëshortit të provuara me dokumentacion ligjor dhe për të cilat janë shlyer detyrimet tatimore, dietat nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, pasi nuk plotësojnë kërkesat e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës dhe kanë destinacion mbulimin e shpenzimeve gjatë udhëtimeve të punës, në lidhje me moskonsiderimin e kursimeve *cash*, në vlerën 500.000 lekë, të deklaruara në DPV-në 2008, si burim për blerjen e automjetit, subjekti nuk solli argumente dhe prova të reja lidhur me pretendimin.
31. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se: (i) Nuk ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën (-) 1.286.527 lekë për blerjen e automjetit “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, në datën 29.04.2009, pasi deklarimet në DPV-në e vitit 2008, e të ardhurave nga paga e saj, paga e bashkëshortit, 336.000 lekë, dieta mesatare e bashkëshortit, 5.760 euro, dhe gjendje *cash*, 500.000 lekë, janë të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar çmimin e blerjes së automjetit. (ii) Nuk ka bërë deklaram të rremë në lidhje më të ardhurat në shitja e automjetit me targë {\*\*\*}, si burim krijimi i pasurisë “automjet” me targë {\*\*\*}, në deklarimin periodik ndoshta mund të ketë pasaktësi si është deklaruar në rend kronologjik burimi i të ardhurave, por fakt është se mjete është shitur brenda periudhës së deklarimit, gjendja e kursimeve

---

<sup>30</sup> Komisioni i ka kaluar subjektit barrë prove, duket se: (i) Ka mungesë burimesh të ligjshme në vlerën -1.286.527 lekë për blerjen e automjetit “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, në datën 29.04.2009. (ii) Ka bërë deklaram të rremë në lidhje me të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {\*\*\*}, në datën 15.10.2009, si burimi i krijimit të pasurisë “automjet Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, pasi ky burim nuk ka ekzistuar në momentin e krijimit të kësaj pasurie datë 29.04.2009. (iii) Ka bërë deklaram fiktiv të çmimit të blerjes së pasurisë “automjet”, me targë {\*\*\*}, pasi në kontratën e shitjes, dt.15.11.2002, së këtij automjeti, çmimi i blerjes 250.000 lekë është pasqyruar më lirë sesa vlera reale e tij, prej 430.281 lekësh, veprim ky që nuk ka logjikë ekonomike. (iv) Ka bërë deklaram fiktiv të çmimit të shitjes së pasurisë “automjet”, me targë {\*\*\*}, pasi në kontratën e shitjes, datë 5.10.2009, është pasqyruar çmimi 900.000 lekë pavarësisht se ky automjet është blerë dyfish më lirë dhe është përdorur 7 vjet.

të deklaruar në fund të çdo periudhe deklarimi provon disponimin e të ardhurave e mjaftueshme, edhe pa përfshirë në datën përkatëse të blerjes çmimin e shitjes nga automjeti që ka shitur po atë vit. (iii) Nuk ka bërë deklarim fiktiv të çmimit të blerjes dhe atij të shitjes së automjetit {\*\*\*}, vlera e blerjes 250.000 lekë dhe ajo e shitjes 900.000 lekë, provohen respektivisht nga kontrata e datës 15.11.2002 dhe ajo e datës 05.10.2009. Komisioni, duke referuar te vlera e blerjes së këtij mjeti, nga shitësi M. K., prej 430.281 lekësh, në mënyrë të padrejtë, konkludon se kjo është vlera reale e mjetit dhe se veprimi i blerjes së këtij mjeti, në vlerën 250.000 lekë, nuk ka logjikë ekonomike. Lidhur me vlerën e shitjes së këtij automjeti, të shtuar nëpërmjet kryerjes së shërbimeve në servise, shërbimet nuk janë kryer në një vlerë të vetme, dhe këto shërbime nuk e kalojnë vlerën 300.000 lekë në vit, e në këto rrethana, duke qenë se nuk ka qenë e detyrueshme dhe duke qenë se nuk është ruajtur dokumentacion, nuk mund të provohet ndryshe. Kontratat e shitblerjes dhe deklarimet periodike vjetore, ku pasqyrohen vlerat e shitblerjes, janë prova të pakontestueshme, nuk mund të jetë kriter matës shitblerja e mjeteve në vite të ndryshme, pa ditur që kanë çuar në shitblerjen e mjetit në atë vlerë, për shkak defekti, nevojës për të ardhura etj., pretendoi subjekti.

32. Nga aktet në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e subjektit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

32.1. Trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit lidhur me vërtetësinë e deklarimeve dhe shpjegimeve të subjektit në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë “automjet *Mercedes-Benz*”, me targë {\*\*\*}, për sa konstatuar dhe vlerësuar në vijim.

32.1.1. Referuar deklaratës *vetting* për blerjen e kësaj pasurie, në datën 29.04.2009, njëri prej burimeve deklarohet prej subjektit, me të ardhura nga shitja në datën 5.10.2009 e automjetit me targë {\*\*\*}, ku për vetë datat e deklaruar të kryerjes së veprimeve duket objektivisht e pamundur, që për blerjen e automjetit objekt analize të jenë përdorur të ardhura nga shitja e një automjeti të ndodhur pesë muaj më pas. Në këtë situatë, deklarimet e subjektit në Komision dëshmojnë qartë mungesën e konsistencës në qëndrimin e saj, duke vënë në dyshim vërtetësinë e çdonjërit prej tyre. Konkretisht, në pyetësorin standard, subjekti deklaroi: “*Burimi i të ardhurave është shitja e mjetit tip “Mercedes-Benz 250D”, me dt. 20.04.2009, por noteria e bëri më dt. 15.10.2009 (për arsye shëndetësore të blerësit)...*”, ka ndryshuar qëndrim në pyetësorin nr. 2, duke deklaruar “*Moskoordinimi i datës së shitjes të shkruar sipas kontratave përkatëse ka ardhur, sepse mjeti është lënë për t’u shitur në pikat ku shiten makina. Me pronarët e këtyre pikave, bashkëshorti kishte njohje personale dhe, në këto kushte, ata bëheshin garant për shitjen e këtyre mjeteve, duke i vlerësuar ato dhe duke i dhënë paraprakisht shumë përkatëse, që na ndihmoi për blerjen e mjeteve të tjera. Pas gjetjes së personit blerës të mjetit, bashkëshorti është njoftuar dhe është paraqitur së bashku me blerësin para noterit, ku kanë formuluar dhe kontratat përkatëse”, dhe në prapësimet për rezultatet e hetimit administrativ, sikundër në ankim, deklaroi se: “*nuk ka bërë deklarim të rremë në lidhje me të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {\*\*\*}, në datën 15.10.2009, që renditen si burimi i krijimit të pasurisë ‘automjet Mercedes-Benz’, me targë {\*\*\*}, mund të këtë pasaktësi në mënyrën si është deklaruar në rend kronologjik burimi i të ardhurave, gjendja e kursimeve e deklaruar në fund të çdo viti provon të ardhurat e mjaftueshme, edhe pa përfshirë në datën përkatëse të blerjes çmimin e shitjes së automjetit po atë vit”.**

32.1.2. Trupi gjykues, nga aktet në dosje konstaton se për automjetin me targë {\*\*\*}, 6 muaj pas datës 20.04.2009, në të cilën subjekti deklaroi shitjen e tij në pyetësorë, nga pronari/bashkëshorti i

subjektit është prerë policë sigurimi me periudhë vlefshmërie 16.09.2009 – 15.09.2010. Përpos kësaj, ndërsa noterja konfirmon lidhjen e kontratës e shitjes së automjetit me targë {\*\*\*},<sup>31</sup> në datën 05.10.2009, sipas certifikatës së pronësisë datë 19.05.2009, z. P. B./bashkëshorti i subjektit, figuron pronar i automjetit me targë {\*\*\*}. Për rrjedhojë, këto fakte provojnë se bashkëshorti i subjektit e ka pasur në pronësi dhe posedim automjetin me targë {\*\*\*}, deri në datën e shitjes së tij, 05.10.2009, dhe jo deri në datën 20.04.2009, pretenduar si datë e shitjes së tij prej subjektit.

32.2. Lidhur me çmimin e blerjes së këtij automjeti, nga aktet në dosjen gjyqësore,<sup>32</sup> rezulton se sipas kontratës së shitblerjes datë 15.11.2002, automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, viti prodhimit 1993, i është shitur nga shitësi M. K. bashkëshortit të subjektit, me çmimin 250.000 lekë.<sup>33</sup> Ky automjet është zhdoganuar nga shitësi në datën 07.09.2002, me vlerë totale 430.281 lekë (200.000 lekë çmimi blerjes<sup>34</sup> + 230.281 taksa zhdoganimi). Në këto rrethana faktike, në vlerësimin e trupit gjykues, shitja e automjetit dy muaj pas zhdoganimit të tij, në pothuaj vlerën e taksës së zhdoganimit, pa përfshirë në çmimin e shitjes vlerën e blerjes së tij, duke mos marrë në konsideratë as kostot e transportit,<sup>35</sup> nuk mund të shpjegohet sipas pretendimeve të subjektit – *shkak defekti, nevojë për të ardhura* – por dëshmon në një nivel bindës, për fiktivitetin e çmimit të deklaruar.

32.3. Më pas, me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} kol., nr. {\*\*\*} rep., datë 05.10.2009, shtetasi P. B., pronar i mjetit sipas lejes së qarkullimit dhe i aktit të pronësisë nr. {\*\*\*}, datë 19.05.2009, i shet blerësit A. B. automjetin “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}, në vlerën 900.000 lekë. Lidhur me vlerën e shitjes së këtij automjeti konstatohet se ka mospërputhje në atë të deklaruar në DPV-në e vitit 2009, ku subjekti deklaron: “*Shitje makine tip ‘Mercedes-Benz 250 D’, në vlerën 700.000 lekë*”, për të cilën subjekti ka shpjeguar: “*Shitja e automjetit me targë {\*\*\*} në fillim është bërë në vlerën 700.000 lekë. Në kontratë është dokumentuar shuma 900.000 lekë, sepse blerësi kërkoi shërbime shtesë, si: disqe, goma, veshje të sediljeve etj., shërbime këto, të cilat e rrisnin vlerën e automjetit. Shuma u korrigjua nga 700.000 lekë në 900.000 lekë, në kontratë brenda të njëjtës ditë, sepse blerësi nuk dëshironte të paguante serish për anulim kontrate dhe kontratë të re, prandaj u korrigjua kontrata fillimisht me shkrim dore mbi kontratë dhe pastaj u shtyp nga e para me shumën e korrigjuar (kjo e lejuar sipas ligjit nr.7829, dt. 01.06.1994, “Për noterinë”). Sipas shpjegimeve të noteres, kjo nuk është kontratë e re, por korrigjim i kontratës së mëparshme*”. Ky version i pretenduar prej subjektit, nuk jep asnjë arsye përse në DPV-në e vitit 2009 është deklaruar një çmim i ndryshëm nga ai i pasqyruar në kontratën e shitjes dhe përforcon dyshimet për vërtetësinë e çdo deklarimi e shpjegimi të subjektit, edhe lidhur me veprimet për shitblerjet e pasurive “automjet”. Pavarësisht kësaj, në procesin e rivlerësimit objekt kontrolli është saktësia e deklarimit të pasurive në deklaratën *vetting* dhe, në këtë rast, vlera e deklaruar për shitjen e automjetit me targë {\*\*\*} rezulton më shumë se 3-fishi i çmimit të blerjes së tij, ndonëse shitja është kryer pas 7 viteve përdorim, periudhë që logjikshëm ndikon në vjetërsimin dhe amortizimin e automjetit. Lidhur me rritjen vlerës së shitjes së automjetit, subjekti ka deklaruar: “*Bashkëshorti me profesion shofer prej 47 vitesh, është prirur gjithmonë nga eksperiencia të gjejë mjete me defekte të lehta teknike dhe estetike, të kenë vlerë të ulët dhe me kalimin e kohës sipas rastit t’i riparojë dhe vlera e shtuar ka ardhur duke investuar në mënyrë graduale për të rritur*

<sup>31</sup> Shkresa datë 06.05.2024, e noteres I. P.

<sup>32</sup> Dosja e automjetit me targë {\*\*\*} është përcjellë nga DPShTRr-ja me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 23.04.2024.

<sup>33</sup> Me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., dt.15.11.2002, noterja ka vërtetuar paraqitjen dhe nënshkrimin personalisht të palëve sa hartuar më sipër, jashtë kësaj zyre noteriale.

<sup>34</sup> Blerë nga pronari, shoqëria “{\*\*\*}” SRL, Itali.

<sup>35</sup> Mjeti ka hyrë në Shqipëri në datën 02.08.2002, sipas “vërtetim hyrje” të Doganës Murriqan.

*komoditetin dhe paraqitjen e tyre. Nuk është mbajtur dokumentacion ligjor për përmirësimet e mjetit, të cilat janë shtrirë në vite dhe vlera e tyre në një vit të vetëm nuk ka qenë më e madhe se vlera e shpenzimit të kërkuar për t'u deklaruar në deklarin periodik të pasurisë". Në prapësimet për rezultatet e hetimit administrativ, sikundër në ankim, subjekti mban të njëjtin qëndrim si cituar më lart, duke shtuar se ajo nuk ka pasur asnjë detyrim për ruajtjen e dokumentacionit që provonte shërbimet e kryera.*

32.4. Në konsideratë të sa më sipër, trupi gjykues i gjen shpjegimet e subjektit përpos se kontradiktore, jobindëse dhe deklarative. Konkretisht, deklarimi për *investime në mënyrë graduale për të rritur komoditetin dhe paraqitjen e automjetit* dedukton se automjeti në momentin e shitjes të kishte parametra optimale sa i përket anës teknike, komoditetin e anës estetike, ndërkohë që deklarimi se blerësi kishte kërkuar shërbime shtesë – *disqe, goma, veshje të sediljeve* – dedukton për gjendje jo optimale të automjetit. Gjithashtu, pavarësisht se ka kaluar afati 10-vjeçar i ruajtjes së dokumentacionit financiar, që provon shpenzimet e kryera nga subjekti pranë serviseve, subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion prej tyre për të konfirmuar se nuk kanë ruajtur dokumentacion për shërbimet/riparimet e automjetit. Përveç argumenteve të mësipërme, trupi gjykues e gjen të pabazuar dhe objektivisht të pamundur pretendimin e subjektit, se pas shtatë vitesh përdorimi, vlera e një automjeti të rritet me trefish, pa ndonjë gjurmë dokumentare të ndërhyrjeve që do të kishin ndryshuar katërçipërisht situatën teknike të mjetit. Pretendimet e subjekti mbetën krejtësisht deklarative dhe të paprovuara, situatë e cila e çon trupin gjykues në përfundimin se është i drejtë vlerësimi i Komisionit, se shpjegimet kontradiktore të subjektit gjatë hetimit administrativ, në lidhje me datat e shitjes së automjetit me targë {\*\*\*}, shitja e këtij automjeti 6 muaj pas blerjes së automjetit me targë {\*\*\*}, me çmim shumë më të lartë sesa çmimi me të cilin e kanë shitur më pas pronarët pasardhës,<sup>36</sup> krijojnë dyshimin e arsyeshëm për fiktivitet të çmimit të shitjes së tij, në vlerën prej 900.000 lekësh, në funksion të justifikimit të burimit për krijimin e automjetit tip “Mercedes-Benz CDI”, me targë {\*\*\*}.

32.5. Lidhur me pretendimin e subjektit se, sipas deklarimeve në DPV-në e vitit 2008, të të ardhurave nga paga e saj, nga paga e bashkëshortit, 336.000 lekë, dieta mesatare e bashkëshortit, 5.760 euro, dhe gjendje *cash* 500.000 lekë, janë të mjaftueshme për të justifikuar çmimin e blerjes së automjetit me targë {\*\*\*}, trupi gjykues vlerëson si vijon. Në deklaratën *vetting*, si burim tjetër për krijimin e kësaj pasurie, subjekti deklaron: *“kursimet nga pagat e përbashkëta”*, të cilin në pyetësin standard e specifikon në shumën 550.000 lekë. Përpos se në DPV-në e vitit 2009, subjekti nuk ka deklaruar këtë shumë si burim për blerjen e automjetit, në këtë deklaratë, subjekti nuk ka deklaruar as pakësim të gjendjes *cash* prej 500.000 lekësh, të deklaruar në DPV-në e vitit 2008. Për më tepër, nga analiza financiare e vitit 2008, subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën (-) 611.903 lekë, duke mos pasur në këtë mënyrë mundësi për krijimin me burime financiare të ligjshme të gjendjes së likuiditeteve *cash*, prej 500.000 lekësh, të deklaruar në DPV-në e vitit 2008. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit, të analizuara gjerësisht në këtë vendim, edhe në variantin garantist, duke përllogaritur të ardhurat nga dietat, për periudhën janar – prill 2009, në shumën 496.656 lekë, sipas dokumentacionit të administruar në fashikull, balanca negative do të reduktohej në vlerën prej (-) 789.871 lekësh.

---

<sup>36</sup> Shtetasi A. B., blerësi i automjetit me targë {\*\*\*}, e shet atë në vitin 2014, në çmimin 150.000 lekë, e më tej, në vitin 2020, automjeti shitet në çmimin 100.000 lekë.

32.6. Në përmbledhje të sa analizuar më lart, lidhur me pasurinë “automjet” tip “Mercedes-Benz CDI”, me targë {\*\*\*}, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë se nuk ka bërë deklaram të rremë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, për sa nuk provoi që dispononte në momentin e krijimit të kësaj pasurie, në datën 29.04.2009, të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {\*\*\*}, të ndodhur në datën 15.10.2009. Gjithashtu, trupi gjykues i vlerëson jobindëse shpjegimet e subjektit, se nuk ka bërë deklaram fiktiv lidhur me çmimin e blerjes së automjetit me targë {\*\*\*}, në vlerë 2-fish më pak se vlera e blerjes së tij, dy muaj më parë, nga shitësi. Duke konfirmuar balancën negative prej (-) 1.286.527 lekësh, sipas analizës financiare të Komisionit për mundësinë e krijimit të kësaj pasurie me burime të ligjshme, në variantin garantist, duke konsideruar në këtë analizë të ardhurat nga dietat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit, për periudhën janar – prill 2009, sipas dokumentacionit të administruar në fashikull, balanca negative do të reduktohej në vlerën prej (-) 789.871 lekësh. Sa më sipër, edhe në kontekst të këtij qëndrimi garantist, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, dhe ka bërë deklaram të rremë lidhur me të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {\*\*\*} si burim krijimi i kësaj pasurie, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016.

*Pasuria “automjet” tip “Citroen C3”, me targë {\*\*\*}*

33. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaron: *Automjet i markës “Citroen C3”, me targë {\*\*\*}, regjistruar në emrin personal, blerë në datën 15.06.2012, me nr. {\*\*\*} rep. Vlera 13.500 euro. Burim krijimi një pjesë nga të ardhurat nga shitja e mjetit “Volkswagen Golf” me targë {\*\*\*}, sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep, datë 19.06.2012, në vlerën 6.000 euro, si dhe kredisë leasing pranë Credins Bank, në datën 15.06.2012, nr. kontrate {\*\*\*}, vlera 8.181 euro. Kredia është në proces shlyerje.*
34. Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës dhe ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e këtij automjeti, pasi në analizë të provave dhe fakteve të administruara, edhe në rastin e kësaj pasurie ka çmuar se të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {\*\*\*}, në vlerën 6.000 euro, bëhen të diskutueshme dhe përforcojnë dyshime të arsyeshme se çmimi i shitjes së automjetit me targë {\*\*\*}, i vendosur në kontratën e shitjes, është fiktiv dhe është bërë më qëllim për të justifikuar burimin e krijimit të automjetit me targë {\*\*\*}.
35. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar në prova, pasi edhe pse ekziston kontrata e shitjes dhe vlera e shitjes është deklaruar në deklaratën e pasurisë, në kundërshtim me parimin e drejtësisë, objektivitetit e proporcionalitetit, Komisioni nuk pranon që shitja e automjetit me targë {\*\*\*} është bërë në shumën 6.000 euro, në datën 05.06.2012.
36. Trupi gjykues, nga aktet në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e subjektit, konstaton dhe vlerëson si vijon.

36.1. Referuar dokumentacionit të paraqitur prej subjektit me deklaratën *vetting*, rezulton se: (i) me kontratë shitblerje automjeti, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.09.2008, pronari I. E.,<sup>37</sup> i përfaqësuar me prokurë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.01.2008, nga z. P. B., bashkëshorti i subjektit, i shet blerëses, Rajmonda Berisha, automjetin tip “Volkswagen Golf 1.6”, me targë {\*\*\*}, vit prodhimi 1998, në vlerën 250.000 lekë, e likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale; (ii) me kontratë

<sup>37</sup> Referuar kontratës, pronësia provohet me leje qarkullimi nr. {\*\*\*}, datë 08.01.2008 dhe certifikatë pronësie nr. {\*\*\*}, datë 07.04.2008.

shitblerje automjeti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol, datë 05.06.2012, subjekti i rivlerësimit i shet këtë automjet blerësve F. dhe A. Xh., në vlerën 6.000 euro, e likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale.<sup>38</sup> Në DPV-në e vitit 2008 deklaroi blerjen e këtij automjeti në vlerën 250.000 lekë dhe në DPV-në e vitit 2012 deklaroi: “Kredi në vlerën 8.181 euro, e marrë te Credins Bank për blerje makine tip ‘Citroen C3’, vlera e saj 13.500 euro në total, e blerë me kredi dhe një pjesë nga shitja e ish-makinës tip ‘Volkswagen’, 6.000 euro.

36.2. Rezulton se automjeti me targë {\*\*\*}, në datën 20.11.2007, është zhdoganuar me vlerë totale 333.450 lekë (çmimi + taksë zhdoganimi) nga shtetasi I. E, i cili në datën 22.01.2008, me prokurën e posaçme nr. {\*\*\*} rep, nr. {\*\*\*} kol., ka autorizuar si përfaqësues z. P. B., duke i dhënë tagra që automjetin ta përdorë, në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, ta shesë duke përcaktuar çmimin e shitjes dhe duke lidhur kontratën e shitjes për llogari të tij, t’ia japë në huapërdorje cilitdo, duke lidhur kontratën përkatëse. Pas 8 muajsh, në datën 26.09.2008, bashkëshorti i subjektit, si përfaqësues i pronarit I. E., nënshkruan me subjektin/blerësen Rajmonda Berisha kontratën e shitjes së automjetit me targë {\*\*\*}, në vlerën 250.000 lekë, të cilën përfaqësuesi ligjor deklaroi se e ka marrë të gjithë në dorë nga blerësja. Kjo e fundit/subjekti, në datën 05.06.2012, pas 4 vite përdorimi, e shet këtë automjet në vlerën 6.000 euro (837.540 lekë), ose 3.3 herë më shumë se çmimi i blerjes. Lidhur me kërkesën për të shpjeguar e provuar me dokumentacion ligjor, përmirësimet e automjetit “Golf”, me targë {\*\*\*}, të cilat kanë ndikuar në shitjen e tij me vlerë më shumë se 3-fishi i vlerës së blerjes, subjekti ka dhënë të njëjtat përgjigje si për automjetin me targë {\*\*\*}, se bashkëshorti gjen mjete me defekte të lehta teknike dhe estetike që kanë vlerë të ulët, i riparoi gradualisht duke i rritur komoditetin dhe paraqitjen e tyre, përmirësimet e mjetit janë shtrirë ndër vite dhe vlera e tyre në një vit të vetëm nuk ka qenë më e madhe se vlera e shpenzimit të kërkuar për t’u deklaruar në deklarinë periodik të pasurisë. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka prapësuar se, meqenëse shërbimet nuk janë kryer në një vlerë të vetme, nuk ka qenë e detyrueshme të deklaroheshin, nuk ka ruajtur dokumentacion dhe nuk mund të provojë ndryshe, dhe se mospranimi i shitjes së automjetit me targë {\*\*\*}, në shumën 6.000 euro, vlerë e deklaruar në kontratën e shitjes dhe DPV-në e vitit 2012, është në kundërshtim me parimin e drejtësisë, objektivitetit dhe të proporcionalitetit.

36.3. Trupi gjykues, *së pari*, konstatoi se edhe në rastin e kësaj pasurie, në kontratën e shitblerjes, vlera e blerjes së automjetit prej subjektit, jo vetëm është më e ulët se vlera e blerjes dhe e zhdoganimit të tij prej pronarit E., por në këtë rast, referuar tagrave të dhëna me prokurën e posaçme, bashkëshorti i subjektit, si pronar “de facto” i automjetit, pas zhdoganimit të tij, ka kryer veprimet juridike për shitjen e tij edhe me të drejtën të caktojë çmimin e shitjes. *Së dyti*, mungesa e dokumentacionit provues për sa pretenduar, qoftë edhe kërkesa drejtuar serviseve apo përgjigje e tyre që nuk disponojnë dokumentacion, raporti 3.3 herë më i lartë i çmimit të shitjes nga ai i blerjes pas 4 vite përdorimi të automjetit, kohë gjatë së cilës automjeti është vjetërsuar dhe amortizuar, e gjithashtu, shitja më pas e tij nga pronarët, në vitin 2014, me vlerë 400.000 lekë, dyfish më pak se vlera që e kanë blerë prej subjektit në vitin 2012, janë rrethana faktike që përforcojnë bindjen për fiktivitet të çmimit prej 6.000 euro, të deklaruar në kontratën e shitjes të përpiluar në datën 05.06.2012. Referuar dokumentit “Aneks B: Plani i Pagesave të qirasë Financiare (Leasing) për kontratën e Qirasë

<sup>38</sup> Në pyetësin standard, subjekti ka korrigjuar gabimin në deklaratën vetting lidhur me datën e shitjes të automjetit me targë {\*\*\*} (si datë e kontratës së shitjes është deklaruar 19.06.2012), duke deklaruar: “Citroen C3, blerë dt. 19.06.2012, me nr. kontrate {\*\*\*}, vlerë 13.500 euro. Burimi i të ardhurave: kredi në Credins Bank, leasing, me dt. 15.06.2012, nr. kontrate {\*\*\*}, në vlerën 8.181 euro; shitja e autoveturës tip Golf 1.6, në dt.05.06.2012, në vlerë 6.000 euro me nr. kontrate {\*\*\*} kol. Mënyra e pagimit u bë kredi + cash”.

*Financiare nr. {\*\*\*}, datë 15.06.2012*”, Credins Leasing, si palë qiradhënëse i jep me qira palës qiramarrëse/subjektit mjetin “Citroen”, blerë nga “{\*\*\*}” ShPK, me çmimin e blerjes 13.500 euro, nga ku qiramarrësi ka parapaguar 5.319 euro, për rrjedhojë, përforcohet dyshimi i arsyeshëm për një çmim fiktiv të shitjes së automjetit me targë {\*\*\*}, në funksion të nevojës për justifikimin me burime financiare të ligjshme të kësaj pagese, sipas dokumentit të sipërcituar. Në vështrim të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, nenit 49/4 të tij,<sup>39</sup> në situatën faktike të ekzistencës së rrethanave që vënë mjaftueshëm në dyshim çmimin në kontratën e shitjes dhe atë të deklaruar në deklaratën e pasurisë, duke cenuar në masë të konsiderueshme vlerën provuese të akteve dhe krijuar bindjen se çmimi i deklaruar është fiktiv, pretendimet e subjektit, se arsyetimi i Komisionit vjen në kundërshtim me parimin e drejtësisë, objektivitetit dhe proporcionalitetit, vlerësohen prej trupit gjykues të pabazuara.

36.4. Për sa më lart, lidhur me pasurinë “*automjet*” tip “*Citroen C3*”, me targë {\*\*\*}, regjistruar në emrin e subjektit, blerë në datën 15.06.2012, në vlerën 13.500 euro, me burim krijimi edhe të ardhura nga shitja e automjetit “*Volkswagen Golf*”, me targë {\*\*\*}, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, se të ardhurat nga shitja e këtij automjeti, të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 6.000 euro, bëhen të pabesueshme, përderisa subjekti dështoi të provojë vlerën e shtuar të automjetit pas 4 vite përdorimi në raport me çmimin e blerjes prej 250.000 lekësh, duke konfirmuar dyshimin e arsyeshëm, se çmimi kontraktual i shitjes është fiktiv, me qëllim për të justifikuar blerjen e automjetit me targë {\*\*\*}. Në këto rrethana, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

37. Lidhur me pretendimin e subjektit, se Komisioni konkludon me të padrejtë për tendencë të përsëritur të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për të deklaruar çmime fiktive në transaksionet (shitjet dhe blerjet) e automjeteve, me qëllim justifikimin e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, duke mbajtur në konsideratë për sa analizuar më lart, sikundër edhe Komisioni, trupi gjykues, duke mos e kundërshtuar ekzistencën e akteve në cilësinë e provës, por në vlerësim të rrethanave faktike, që vënë në dyshim çmimin e deklaruar në akte, çmon se vlera provuese e akteve (kontratës së shitjes dhe DPV-ve) cenohen në atë masë, saqë krijojnë bindjen se, lidhur me pasuritë automjet me targë {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, çmimi i deklaruar i shitjes së tyre është fiktiv. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për rritje të vlerës së automjeteve të shitura, si pasojë e investimeve për përmirësimin e tyre, mbetën deklarative dhe të paprovuara. Bazuar në këto rrethana faktike, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, kualifikim i cili nuk gjendet i drejtë nga trupi gjykues. Në këtë kontekst, për pasuritë “automjete” si më sipër, trupi gjykues vlerëson se konkluzionet nuk mund të konsiderohen sërish edhe në kontekstin e vlerësimit të përgjithshëm të të tria kriterëve sipas nenit 4, pika 2 e këtij ligji, por ato konsiderohen si problematika që afektojnë nivelin e besueshmërisë së subjektit në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

*Pasuria “automjet” tip “Smart Coupe”, me targë {\*\*\*}*

38. Në deklaratën vetting, subjekti deklaroi: “*Automjet i markës ‘Smart Coupe’, me targë {\*\*\*}, regjistruar në emër të vajzës, Xh. B., blerë në datën 26.11.2014, me nr. {\*\*\*} rep., me certifikatë*

<sup>39</sup> “Komisioni dhe Kolegji i Apelit në bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.”

*doganore {\*\*\*} Elbasan, {\*\*\*}, datë 27.11.2014. Vlera 100.000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit. Personi i lidhur, vajza e subjektit, Xh. B., ka deklaruar edhe 'Pjesa që zotëron 100%'".*

39. Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës se: *“duket se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit “Smart Coupe”, pasi në datën e blerjes, 26.11.2014, rezultoi me balancë negative në vlerën (-)174.836 lekë”,* balancë negative e rezultuar nga analiza financiare për periudhën 01.01.2014 – 26.11.2014. Lidhur me këtë gjetje të Komisionit, subjekti nuk ka paraqitur shpjegime në prapësimet për rezultatet e hetimit dhe, për pasojë, Komisioni i ka qëndruar konstatimit të mësipërm edhe në vendimin objekt gjykimi.
40. Subjekti i rivlerësimit në ankim, lidhur me këtë pasuri, citon rezultatin e hetimit administrativ kryesisht të Komisionit, pa ngritur ndonjë shkak ankimi për konkluzionin e tij apo lidhur me balancën negative.
41. Në këtë situatë faktike, lidhur me këtë pasuri, konfirmohet mungesa e burimeve të ligjshme për të gjithë vlerën e saj sipas analizës financiare të Komisionit, ndërsa në variantin garantist, duke konsideruar në këtë analizë të ardhurat nga dietat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit, për periudhën janar – nëntor 2014, sipas dokumentacionit të administruar në fashikull, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie me burime financiare të ligjshme.

*Depozita bankare në emër të vajzave të subjektit të rivlerësimit, Xh. B. dhe H. B.*

42. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaron pasuritë: *“Depozitë bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank, dega Elbasan, në emër të vajzës, Xh. B., krijuar në datën 30.12.2003. Vlera 359.809,61 lekë. Burimi i krijimit: vazhdim i llogarisë Futura, hapur nga subjekti dhe bashkëshorti, nga kursimet prej pagave (deklaruar edhe nga vajza e subjektit, Xh. B., ‘Pjesa që zotëron është 100%’); si dhe “Depozitë bankare pranë Bankës Sparkasse Heidelberg Gjermani, në emër të vajzës H. B., për efekte studimi. Vlera 8.077,59 euro. Burimi i krijimit: Llogaria Futura, krijuar në datën 30.12.2003, pranë Intesa Sanpaolo Bank, Elbasan. Aktualisht llogaria është mbyllur në datën 29.03.2016 dhe është kaluar pranë bankës gjermane më lart. Llogaria ka ardhur si rrjedhim i kursimeve nga pagat e saj dhe të bashkëshortit (deklaruar edhe nga vajza e subjektit, H. B., ‘Pjesa që zotëron është 100%’).”*
43. Lidhur me depozitat në Intesa Sanpaolo Bank, në emër të vajzave, Xh. dhe H. B., të çelura në datën 30.12.2003, nga bashkëshorti i subjektit, nëpërmjet depozitimeve të shumave, respektivisht 150.000 lekë dhe 100.000 lekë, të shtuara në datën 04.04.2007 me 1.000.000 lekë (nga 500.000 lekë në secilën depozitë), të shtuara edhe në datën 10.12.2007 me 800.000 lekë (nga 400.000 lekë në secilën depozitë), Komisioni ka konkluduar se subjekti dhe bashkëshorti i saj: (i) kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e shumave të depozituara në datën 30.12.2003, pasi analiza financiare e vitit 2003 ka rezultuar me balancë negative në shumën (-) 110.886 lekë; (ii) kanë pasur mundësi financiare për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumat e depozituara në datën 04.04.2007; (iii) kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e shumave të depozituara në datën 10.12.2007, pasi analiza financiare për periudhën 05.04.2007 – 31.12.2007 ka rezultuar me balancë negative në shumën (-) 3.867.103 lekë.

44. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këto depozita bankare në emër të vajzave, pretendon se për vitin 2003 dhe 2007 nuk ekzistojnë balanca negative, por Komisionit i rezultojnë të tilla për shkak të analizës financiare të fragmentuar dhe të mospërfshirjes së të ardhurave të bashkëshortit nga puna, si edhe të dietave vjetore që ai përfitonte.
45. Trupi gjykues, nga dokumentacioni i administruar në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e subjektit, konstaton dhe vlerëson si vijon.

45.1. Lidhur me këto depozita, në deklaratat periodike të pasurisë, subjekti deklaron: (i) në DPV-në e vitit 2003: “*Depozitë Futura A.B.A. Vlera 0.15 Mln, në Bankën Amerikane. Burimi i krijimit: nga pagat*” dhe “*Depozitë Futura A.B.A., në emër të fëmijëve. Vlera 0.1 Mln, në Bankën Amerikane. Burimi i krijimit: nga pagat*”; (ii) në DPV-në e vitit 2011: “*Depozitë bankare tek Intesa Sanpaolo, e vajzës Xh. B., në vlerën 1.307.040 lekë*” dhe “*Depozitë bankare tek Intesa Sanpaolo, e vajzës H. B., në vlerën 1.311.588 lekë*”; (iii) në DPV-të e viteve 2012, 2013, 2014, 2015 janë deklaruar interesat vjetore të depozitës ekzistuese të vajzës Xh., pranë Intesa Sanpaolo Bank, në vlerat respektive: 88.774,76 lekë; 47.661,55 lekë; 12.588,40 lekë; 8.460,80 lekë; (iv) në DPV-të e viteve 2013, 2014 dhe 2015 janë deklaruar interesat vjetore të depozitës ekzistuese të vajzës H., pranë Intesa Sanpaolo Bank, në vlerat respektive 84.301,78 lekë, 118.819 lekë dhe 12.963,71 lekë.

45.2. Gjatë hetimit administrativ,<sup>40</sup> subjekti ka deklaruar se burimi i të ardhurave në shtimin e depozitave të vajzave, me shumat 500.000 lekë dhe 400.000 lekë, në vitin 2007, si dhe depozitimi, po në këtë vit, i shumave 200.000 lekë dhe 5.000 euro, në llogarinë e përbashkët të saj dhe të bashkëshortit, janë të ardhurat nga puna e bashkëshortit të saj si shofer, prej disa vitesh në transport ndërkombëtar. Gjithashtu, ai ka siguruar të ardhura dhe nga pagesat që ka marrë nga emigrantët shqiptarë jashtë shtetit për shërbimet që u mundësonte, duke u sjellë nga shteti grek, për familjarët e tyre në Shqipëri dhe anasjelltas, mallra apo dokumentacion, veprim ky që njihet gjerësisht se kryhet nga të gjithë shoferët e linjave ndërkombëtare. Shumat në emër të vajzave si depozitë bankare (*Futura*) në këtë vit u vendosën sepse Intesa Sanpaolo Bank e ofronte këtë depozitë të favorshme për fëmijë, me përqindje të lartë interesi. Ndërsa shumat e depozituara në llogarinë e përbashkët midis subjektit dhe bashkëshortit janë kursime nga të ardhurat nga puna e tyre, të cilat në atë moment kanë vlerësuar për t’i depozituar në bankë. Me përgjigjen, subjekti ka depozituar dokumentacion lidhur me punësimin e bashkëshortit si shofer kamioni në transportin ndërkombëtar, respektivisht: (i) vërtetimin e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën 05.10.1993 – 13.11.1995, me pagë sipas rrugëve që kryente, në total 25.000 USD, por i pashoqëruar me dokumentacion provues, pasi shoqëria nuk disponon asnjë dokument për pagat, si pasojë e trazirave të vitit 1997, ku u dogj i gjithë dokumentacioni i kësaj shoqërie; (ii) vërtetim nga E. B.,<sup>41</sup> që konfirmon se P. B. ka punuar pranë shoqërisë së transportit “{\*\*\*}”, si shofer kamioni në transportin ndërkombëtar, në periudhën 01.03.1996 – 17.02.2003, ka përfituar pagë 54.000 marka gjermane, koha aktive 4-5 muaj/vit, e paguar me 2.000 marka gjermane plus dieta në transfertë.

45.3. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirje në analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortit nga puna dhe dietat, trupi gjykues ka mbajtur tashmë një qëndrim në arsyetimin më lart të këtij vendimi, duke e konsideruar atë të pabazuar, pasi subjekti ka dështuar të provojë ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara për periudhën 1993 – 2003, pranë shoqërive të sipërcituara, në kuptim të

<sup>40</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

<sup>41</sup> Nuk shënohet se me çfarë cilësie ky person ka lëshuar këtë vërtetim.

parashikimeve kushtetuese dhe ligjore të kuadrit ligjor të rivlerësimit. Nga kontrolli i analizës financiare të vitit 2003, ku janë përfshirë vetëm të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit,<sup>42</sup> balanca negative e Komisionit, prej (-)110.886 lekësh, konfirmohet, si rrjedhojë, subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi që të depozitonin shumat në depozitat e vajzave Xh. dhe H. B., si dhe të përballonin shpenzimet e jetesës.

45.4. Lidhur me pretendimet e subjektit se, për shkak të kryerjeve të analizave të fragmentuara dhe jovjetore, ajo rezulton me balanca negative, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi nga analiza financiare e Komisionit, për periudhën 2003 – 2016, subjekti ka rezultuar me balancë negative, si në vitin 2003, ashtu edhe në vitin 2007, të cilat konfirmohen edhe nga kontrolli i kryer në Kolegj.

45.5. Për sa më sipër, lidhur me pasuritë “*depozita bankare në emër të vajzave të subjektit të rivlerësimit, Xh. B. dhe H. B.*”, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e depozitave “Futura”, në datën 30.12.2003, në shumën prej 150.000 lekësh dhe në shumën prej 100.000 lekësh, si dhe për depozitimet respektive, prej 400.000 lekësh të kryera, në datën 10.12.2007, duke u kualifikuar kjo situatë sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*Pasuria “llogari bankare pranë Raiffeisen Bank”, Elbasan, e kaluar në fondin “Invest Prestige”*

46. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaroi “*Llogari bankare pranë Raiffeisen Bank, Elbasan, dt.10.12.2010, me nr. klienti {\*\*\*}, shumë e cila aktualisht ka kaluar në fondin ‘Invest Prestige’ pranë kësaj banke. Vlera 460.000 lekë. Pjesa që zotëron 100%. Burimi i krijimit: Paga si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, përpara kalimit të llogarisë së pagës pranë Bankës Credins*”.
47. Komisioni, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime kontradiktore, pasi nga njëra anë shpjegon se në deklaratën *vetting* mund të ketë pasur pasaktësi në mënyrën se si është deklaruar, por nga ana tjetër, lidhur me burimin e krijimit të fondit të investimit, pretendon që nuk ka pasur ndryshim deklarimi, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës se – *nuk ka deklaruar saktë në deklaratën vetting burimin e krijimit të fondit të investimit në Raiffeisen Prestigj, pasi si burim nuk ka shërbyer depozita 460.000 lekë, e krijuar nga pagat në datën 10.12.2010, por likuiditetet e mbartura dhe të deklaruara më parë në shtëpi.*
48. Subjekti i rivlerësimit, duke pasqyruar sa deklaruar në deklaratën *vetting* dhe DPV-në e vitit 2012, lidhur me këtë pasuri, pretendon se vetë Komisioni ka pranuar se, nga leximi i deklaratave periodike për gjendjen e *cash-it*, ka konstatuar se për vitin 2011, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në vlerat 1.500.000 lekë dhe 16.000 euro, për vitin 2012 ka deklaruar gjendje *cash* në vlerat 700.000 lekë dhe 8.000 euro, pra duket se subjekti ka pasur gjendje *cash* për krijimin e fondit të investimit, por balancat negative që kanë rezultuar nga analiza financiare për vitet 2003 – 2011, cenojnë ligjshmërinë e kursimeve *cash* të deklaruara si burim krijimi për këtë investim. Në deklaratën *vetting* mund të ketë pasur pasaktësi në mënyrën si është deklaruar, por nuk ka ndryshim deklarimi lidhur me burimin e të ardhurave për krijimin e fondit të investimit në Raiffeisen Prestige, me dokumente dhe shpjegime të detajuara në seancën dëgjimore ka provuar se bashkëshorti ka përfituar të ardhura nga subjektet që

<sup>42</sup> Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të përfituara nga puna pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, të cilat vërtetohen edhe nga ISSH-ja.

ka punuar për periudhën 2005 – 2016, analiza financiare në mënyrë të fragmentuar, duke mos konsideruar të ardhurat nga dietat të bashkëshortit, arrin në mënyrë të padrejtë në konkluzion për mungesë të burimeve financiare, potencon subjekti.

49. Trupi gjykues, nga aktet në dosjen gjyqësore, konstaton dhe vlerëson si vijon.

49.1. Referuar deklaratës *vetting*, krijimi i pasurisë objekt analize është kryer përmes shumës së llogarisë bankare pranë Raiffeisen Bank Elbasan, dt. 10.12.2010, me nr. klienti {\*\*\*}, me vlerë 460.000 lekë.

49.2. Sipas të dhënave nga Raiffeisen Bank<sup>43</sup> rezulton se, në datën 10.10.2010, subjekti ka krijuar depozitën bankare në shumën 460.000 lekë, me afat 1-vjeçar, nga gjendja e mbartur në llogarinë e pagës së saj në Raiffeisen Bank. Në vijim, gjatë viteve 2010 – 2013, kjo depozitë është maturuar dhe riinvestuar dhe, në datën 20.12.2013, depozita është maturuar në shumën 413.680 lekë<sup>44</sup>. Ndërkohë, nga dokumentacioni i përcjellë nga Raiffeisen Invest<sup>45</sup> rezulton se, në datën 03.05.2012, subjekti ka depozituar *cash* shumën 604.000 lekë në llogarinë e pagës (të njëjtën llogari me depozitën 460.000 lekë) dhe, në po të njëjtën datë, 03.05.2012, i ka blerë kuota, në shumën 600.000 lekë, në Raiffeisen Prestige.<sup>46</sup>

49.3. Referuar deklaratave të pasurisë, trupi gjykues konstaton se deklaratimet e subjektit lidhur me pasurinë objekt analize janë si vijon: në DPV-në e vitit 2010, “*Depozitë e ngelur nga paga në vite tek Raiffeisen Bank, vlera 460,000 lekë*” dhe në DPV-në e vitit 2012, “*Depozitë në formë investimi në fondin e investimit tek Raiffeisen Bank, vlerë e cila rrjedh nga likuiditetet e mbartura dhe të deklaruara më parë në shtëpi. Vlera 600.000 lekë*”.

49.4. Në Komision, në përgjigje të barrës së provës – *duket se subjekti nuk ka deklaruar saktë në deklaratën vetting burimin e krijimit të fondit të investimit në Raiffeisen Prestige, pasi si burim nuk ka shërbyer depozita 460.000 lekë, e krijuar nga pagat në datën 10.12.2010, por likuiditetet e mbartura dhe deklaruara më parë në shtëpi* – sikundër në ankim, subjekti deklaroi se mund të ketë pasur pasaktësi në mënyrën si është deklaruar, por nuk ka pasur ndryshim deklarimi lidhur me burimin e të ardhurave për krijimin e fondit të investimit në Raiffeisen Prestige. Me parashtrimet, subjekti ka depozituar disa dokumente, duke u shprehur se nga përmbajtja e tyre provohet vendosja nga Rajmonda Berisha e depozitës në Raiffeisen Invest<sup>47</sup>.

49.5. Sa më sipër, trupi gjykues gjen të bazuar dhe të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti nuk ka deklaruar saktë në deklaratën *vetting* burimin e krijimit të fondit të investimit në Raiffeisen Prestige. Duke evidentuar shpjegimet e vetë subjektit, se mund të ketë pasur pasaktësi në deklarimin në deklaratën *vetting*, lidhur me burimin e të ardhurave për krijimin e fondit të investimit në Raiffeisen

<sup>43</sup> Shkresa e Raiffeisen Bank me nr. {\*\*\*} prot., datë 19.07.2017.

<sup>44</sup> Në datën 10.12.2011, depozita është maturuar në shumën 483.598 lekë; në datën 12.12.2011 është investuar shuma 400.000 lekë, në një depozitë të re 1-vjeçare (12.12.2011 – 12.12.2012) e maturuar në datën 12.12.2012, në shumën 419.493 lekë; në datën 20.12.2012, shuma 400.000 lekë është investuar në një depozitë të re 1-vjeçare (20.12.2012 – 20.12.2013) e maturuar në datën 20.12.2013, në shumën 413.680 lekë.

<sup>45</sup> Shkresa e Raiffeisen Invest me nr. {\*\*\*} prot, datë 26.02.2021.

<sup>46</sup> Nga dokumentacioni bankar rezulton se nga fondi Raiffeisen Prestige, subjekti ka përfituar, në datën 17.04.2013, shumën 41.718 lekë dhe në datën 24.10.2013, shumën 199.488 lekë.

<sup>47</sup> Subjekti citon vërtetim datë 15.01.2021, të lëshuar nga Raiffeisen Bank, dhe katër fletë të lëshuara nga Raiffeisen Bank, në datën 18.01.2021, 05.05.2020 dhe 24.04.2019.

Prestige, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka pasur ndryshim deklarimi të burimit të krijimit të këtij fondi. Nga të dhënat e dokumentacionit bankar, si referuar më sipër, trupi gjykues konstaton se blerja e kuotave është bërë nga depozitimi *cash* në llogarinë bankare, mbështetur kjo edhe nga vetë deklarimi i subjektit në DPV-në e vitit 2012. Për blerjen e kuotave në Raiffeisen Prestige ka shërbyer shuma prej 604.000 lekë, e depozituar nga subjekti *cash*, në datën 03.05.2012, ndërkohë që depozita në shumën 460.000 lekë vazhdon të ishte gjendje për t'u maturuar në datën 20.12.2013. Gjithashtu, referuar dokumenteve të paraqitura prej subjektit me prapësimet në Komision, në përgjigje të barrës së provës, trupi gjykues konstaton se në to referohen të dhëna mbi gjendjen e llogarive të subjektit në Raiffeisen Bank, që i përkasin periudhës 2017 – 2020, e për rrjedhojë, nuk përcjellin asnjë informacion në funksion të provueshmërisë së veprimeve që kanë ndodhur në kohën kur janë krijuar depozitat pranë kësaj banke.

49.6. Lidhur me pretendimin e subjektit, se vetë Komisioni ka konstatuar se, referuar deklarimeve të gjendjes *cash* në DPV-të e vitit 2011 dhe të vitit 2012, duket se subjekti ka pasur gjendje *cash* për krijimin e fondit të investimit, por balancat negative që kanë rezultuar nga analiza financiare për vitet 2003 – 2011, cenojnë ligjshmërinë e kursimeve *cash* të deklaruara si burim krijimi për këtë investim, trupi gjykues, *së pari*, vëren se Komisioni e bën këtë konstatim në funksion të analizimit të deklarimit të subjektit në DPV-në e vitit 2012. Në këtë kontekst, trupi gjykues sjell në vëmendje se në procesin e rivlerësimit objekt kontrolli është saktësia e deklarimit të pasurive në deklaratën *vetting*, si dhe mjaftueshmëria e burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive. *Së dyti*, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, deklaratat e pasurisë mund të përdoren si provë, e deklarimi në DPV-në e vitit 2012 – *Depozitë në formë investimi në fondin e investimit tek Raiffeisen Bank, vlerë e cila rrjedh nga likuiditetet e mbartura dhe të deklaruara më parë në shtëpi* – dedukton për referim në deklaratat e pasurisë të viteve pararendëse dhe, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit për periudhën 2003 – 2011, konfirmohet pamundësia e subjektit për të krijuar me burime financiare të ligjshme likuiditetet *cash* të deklaruara në DPV-në e vitit 2011 dhe në DPV-në e vitit 2012. Pretendimet e subjektit për analizë financiare të fragmentuar, sikundër edhe për përfshirje në analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortit nga dietat, për sa analizuar gjerësisht në këtë vendim, vlerësohen nga trupi gjykues të pabazuara.

49.7. Për sa më sipër, lidhur me pasurinë “*llogari bankare pranë Raiffeisen Bank*”, Elbasan, të krijuar në datën 10.12.2010, me nr. klienti {\*\*\*}, shumë e cila aktualisht ka kaluar në fondin Invest Prestige pranë kësaj banke, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84.2016.

#### *Lidhur me analizën financiare 2003 – 2016*

50. Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara, lidhur me analizën financiare, ka vlerësuar në mënyrë të përmbledhur se: (i) Në lidhje me të ardhurat nga puna dhe dietat e bashkëshortit nuk u provua ligjshmëria e këtyre të ardhurave dhe as vlera fikse e tyre, deklarimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, sa i përket të ardhurave nga punësimi kryesisht janë deklaruar në vlera më të mëdha, ndryshe nga sa provohet nga vërtetimet e pagave për të ardhurat e përfituara për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, të cilat rezultojnë në vlera më të vogla, dhe këto vlera janë përfshirë në analizën financiare. (ii) Analiza financiare e paraqitur nga subjekti me prapësime nuk është bindëse, pasi është bazuar në deklarimet e subjektit në deklaratat periodike të pasurisë dhe jo në dokumentacion ligjor, dhe ka pasaktësi lidhur me pasqyrimin e vlerave të

likuiditeteve bankare, si dhe ka përjashtuar përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, shkollimit, qirasë, mobilimit etj. (iii) Balanca pozitive e pretenduar prej subjektit nuk qëndron, pasi analiza financiare e depozituar prej saj, në cilësinë e provës, hartuar mbi bazën e deklarimeve të subjektit dhe personit të lidhur, rezulton me balancë negative në vitet 2004, 2007, 2009 dhe 2011. (iv) Edhe sikur të merreshin në konsideratë dietat për efekt të analizës financiare, balanca negative, për periudhën 2003 – 2016, do të rezultonte në shumën (-) 9.880.244 lekë, shumë e konsiderueshme për të ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore, në masën e shkarkimit nga detyra. (v) Vlera e pasurive dhe e shpenzimeve të tjera të subjektit dhe e personave të lidhur me të është disa herë më e madhe se vlera e të ardhurave, prandaj nuk mund të zbatohet parimi i proporcionalitetit. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për periudhën 1992 – 2002, në shumën (-) 1.510.403 lekë dhe, për periudhën 2003 – 2016, në shumën (-) 16.656.591 lekë.

51. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në analizën financiare duhet të përfshihen (i) të ardhurat e siguruara nga puna e bashkëshortit, të cilat ILDKPKI-ja i ka përfshirë në analizën financiare, duke konkluduar në raportin e dërguar në Komision se “*ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*”; (ii) gjendja *cash* në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit, se *pasaktësitë në deklarime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive*, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit. Sipas subjektit, nga analiza financiare e detajuar, paraqitur në Komision, konfirmohet se ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar pasuritë, gjendjen *cash* dhe gjendje të tjera likuiditetesh, me të cilat ka krijuar pasuri dhe ka mbuluar shpenzimet.
52. Trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, e gjen të drejtë balancën negative të konstatuar, prej (-) 1.510.403 lekësh, për periudhën 1992 – 2002, dhe prej (-) 16.656.591 lekësh, për periudhën 2003 – 2016, të rezultuar sipas një qëndrimi garantist, që redukton shpenzimet e jetesës së bashkëshortit të subjektit për kohën e qëndrimit në udhëtime pune, në situatën kur prej Komisionit nuk janë përlllogaritur të ardhurat nga dietat. Trupi gjykues, në qëndrimin garantist të konsiderimit të të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti në formën e “dietave”, të provuara përmes dokumentacionit në fashikull, e në këtë rast duke përlllogaritur shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit të rivlerësimit në numër të plotë prej pesë anëtarësh, konstaton se balanca negative, për periudhën 2003 – 2016, do të rezultonte në vlerën (-) 10.063.801 lekësh, duke u gjendur edhe në këtë kontekst në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
53. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve, duke mos arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë e duke u gjendur në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 780, datë 03.07.2024, që ka vendosur caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, gjendet i bazuar në prova dhe në ligj.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit 780, datë 03.07.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Rajmonda Berisha (Kopaçi).
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 11.12.2025, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*